REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE

DISERTACION

I

PARAQITUR NGA

Z. Zamir DAMANI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

SPECIALITETI: Mjekësia Interne dhe HTA

TEMA: Çrregullimet e Metabolizmit Lipidik dhe Korrelacioni me HTA në Shtatzëni

Udhëheqës Shkencor: Prof. Dr. PETRIT BARA

TIRANË 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE

DISERTACION

I

PARAQITUR NGA

Z. Zamir DAMANI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

SPECIALITETI: Mjekësia Interne dhe HTA

TEMA: Çrregullimet e Metabolizmit Lipidik dhe Korrelacioni me HTA në Shtatzëni

Udhëheqës Shkencor: Prof. Dr. PETRIT BARA

MBROHET ME DATË...../...../2016 PARA JURISË

1. _____**KRYETAR**
2. _____**ANËTAR (OPONENT)**
3. _____**ANËTAR (OPONENT)**
4. _____**ANËTAR**
5. _____**ANËTAR**

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE IV
FALENDERIME V
LISTA E SHKURTIMEVE VI
1. HYRJE VII
1.1. Të dhëna historike mbi hipertensionin arterial VII
1.2. Epidemiologjia e hipertensionit arterial IX
1.3. Fiziologjia patologjike e hipertensionit arterial X
1.4. Lipoproteinat XII
1.5. Hipertensioni i induktuar gjatë shtatzënisë XXII
1.6. Fiziologjia patologjike e eklampsisë dhe preeklampsisë XXV
2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT 1
2.1. Qëllimi i Studimit 1
2.2. Objektivat Specifike të Studimit 1
2.3. Hipotezat e Studimit 2
3. METODOLOGJIA 3
3.1. Popullata në studim 3
3.2. Prelevimi i kampionaturës 3
3.3. Analiza statistikore 13
4. REZULTATE 14
5. DISKUTIME 32
5.1. Përmbledhje e gjetjeve kryesore të studimit 32
5.2. Krahasimi i rezultateve me raportimet në literaturë 34
6. PËRFUNDIME 50
7. REKOMANDIME 51
8. LITERATURE 52

PARATHËNIE

Ky studim ofron evidencë të re dhe shumë të rëndësishme mbi etiologjinë e hipertensionit të induktuar arterial të shtatzënisë në Shqipëri. Në mënyrë specifike, punimi aktual ofron një panoramë të detajuar të shpeshtësisë dhe shpërndarjes së hipertensionit të induktuar arterial të shtatzënisë në popullatën femërore në vendin tonë.

Punimi aktual përcakton qartë shumë nga faktorët madhorë të rrezikut për zhvillimin e hipertensionit të induktuar arterial të shtatzënisë tek femrat shqiptare. Të kuptuarit se cili faktor demografik, social-ekonomik apo biokimik mund të ndikojë në proçeset fillestare që nxisin zhvillimin e sëmundjes, kronicitetit e saj dhe koomorbiditetet që shoqërojnë hipertensionin të induktuar arterial të shtatzënisë, kanë një rëndësi themelore për çdo përpjekje që bëhet në drejtim të parandalimit të kësaj sëmundjeje dhe të gjitha pasojave të saj.

Në këtë drejtim, janë bërë përparime të vogla pasi shumë pak burime ka në këtë fushë të shëndetësisë aktualisht në Shqipëri.

Ndonëse në etiologjinë e hipertensionit të induktuar arterial të shtatzënisë janë implikuar një numër i madh faktorësh të ndryshëm, për shumicën e tyre raportohen rezulatate konfliktuale, duke bërë të domosdoshme zhvillimin e studimeve të tjera më domethënëse.

Faktorë të ndryshëm të stilit të jetesës tek femrat si konsumi i alkoolit, i duhanit, i kripës, apo i yndyrnave shtazore, por edhe mosha e avancuar e shtatzënive janë duke u konsideruar gjithnjë e më tepër si faktorë rreziku për zhvillimin e hipertensionit të induktuar arterial të shtatzënisë.

Studimi aktual përshkruan në mënyrë të hollësishme shpërndarjen e faktorëve madhorë të rrezikut për zhvillimin e hipertensionit të induktuar arterial të shtatzënisë në popullatën e femrave të qytetit të Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë me lëvizje demografike të mëdha në 25 vitet e fundit dhe, nga kjo pikëpamje, rezultatet e këtij punimi mund të përgjithësohen për të gjithë popullatën e femrave në Shqipëri.

Rezultatet e këtij studimi do t'i shërbejnë jo vetëm specialistëve të obsetrikë-gjinekologjisë, laboratorit biokimik-mikrobiologjik, kardiologjisë dhe mjekëveë të tjerë klinicistë, por edhe të gjithë punonjësve të sistemit të shërbimeve shëndetësore në Shqipëri, veçanërisht politikë-bërësve dhe vendim-marrësve të sektorit shëndetësor që janë të interesuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore të popullatës shqiptare.

FALENDERIME

Dëshiroj të falenderoj përzemërsisht udhëheqësin tim shkencor, Prof. Dr. Petrit BARE për mbështetjen dhe inkurajimin e tij të vazhdueshëm përgjatë gjithë periudhës së studimit tim shkencor dhe hartimit të dizertacionit përfundimtar.

Dëshiroj të falenderoj gjithashtu Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, për bashkëpunimim e ngushtë, miqësor dhe dashamirës, si dhe të falenderoj të gjithë kolegët që punojnë në Spitalin Universitar "Nënë Tereza" dhe atë Gjinekologjik "Koço Gliozheni" në Tiranë për atmosferën inkurajuese, mbështetëse dhe miqësore në mjedisin e punës.

Falenderime të shumta kam edhe për të gjithë miqtë që më kanë mbështetur fuqimisht në të gjitha etapat e këtij studimi.

Së fundi, falenderimet më të veçanta i'a rezervoj familjes sime, dhe prindërve për mbështetjen e vazhdueshme dhe inkurajimin e pashtershëm përgjatë gjithë periudhës së realizimit të këtij studimi shkencor.

LISTA E SHKURTIMEVE

PA - Presioni Arterial

PS – Presioni Sistolik

PD – Presioni Diastolik

HISH - Hipertensioni i Induktuar i Shtatzënisë

HTA - Hipertensioni arterial

OBSH- Organizata Botërore e Shëndetësisë

SHNH - Shoqata Ndërkombëtare e Hipertensionit

SNQ - Sistemi Nervor Qendror

SRAA - Sistemi Reninë-Angiotensinë-Aldosteron

RVP - Rezistenca Vaskulare Periferike

EV - Endotelin Vaskular

HRV - Hipertensioni Renovaskular

SNS - Sistemi Nervor Simpatik

GJM - Gjëndrat Mbiveshkore

TC- Tomografia e Kompjuterizuar

AIK - Ataku Ishemik Kalimtar

KKPZVTH - Komisioni Kombëtar i Përbashkët për Zbulimin, Vlerësimin dhe Trajtimin e Presionit të Lartë të Gjakut

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

SNA - Sistemi Nervor Autonom

1. HYRJE

1.1. Të dhëna historike mbi hipertensionin arterial

Hipertensioni arterial (HTA) mbetet aktualisht një nga sëmundjet më të përhapura në rang botëror, duke prekur mbi 1.5 miliardë njerëz (1). Incidenca e HTA po vjen gjithnjë duke u rritur edhe për shkak të rritjes së moshës mesatare të popullatës. HTA rezulton të jetë sëmundja që konsumon numrin më të madh të vizitave mjekësore dhe të përdorimit të barnave, e krahasuar me çdo sëmundje tjetër (2-5). I quajtur ndryshe "vrasësi i heshtur", HTA përbën një nga shkaqet kryesore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë kardiovaskulare. Megjithë njohjen deri në detaje të rrezikut të HTA të fshehtë dhe të pakontrolluar, në përgjithësi ai nuk mjekohet ose nuk kontrollohet siç duhet (6). Një nga arsyet e mosmjekimit siç duket të HTA është natyra asimptomatike e tij në rreth 15-20% të rasteve, megjithë dëmtimin progresiv që shkakton sëmundja në organe të caktuara të organizmit human (7).

Megjithëse për shumicën e rasteve mbeten ende të panjohura shkaktarët dhe mekanizmat specifike, është provuar plotësisht se kjo sëmundje, edhe nëse nuk mund të parandalohet, ajo mund të ngadalësohet mjaftueshëm në progresin e saj patologjik. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Hipertensionit (SHNH), ende sot, 7 në çdo 10 individë me hipertension, nuk trajtohen mjaftueshëm. Kështu, statistikat tregojnë se 10% e pacientëve kanë nivele të larta të shifrave të HTA, 60% kanë nivele normale dhe 30% kanë nivele të ulëta, megjithëse marrin mjekim specifik për këtë sëmundje (8-10).

Dokumentet arkivore që në lashtesi, të datuar rreth viteve 2600 p.e.s, evidentojnë se akupunktura, venotomia dhe gjakderdhja e lirë, ishin të vetmet teknika për trajtimin e kësaj sëmundje, e quajtur "sëmundja e pulsit të fortë" (11). Biblioteka Ashurbanipl në Ninivë (669-626 p.e.s.) jep detaje mbi përdorimin e dy procedurave të fundit. Kontribute shkencore të cilët kanë lënë gjurmë, u përkasin Perandorit të "Verdhë" të Kinës, Chou 2600 p.e.s., Cornelius Celsus në Romën e Lashtë, Galen (131-201 e.j), Erisistrates, apo edhe Hipokrati, ku pothuajse të gjithë rekomandonin venotominë. Sorovas i Efesit në 120 e.j. rekomandoi përdorimin e kupave në shpinë (12-14).

Progresi në studimin e sëmundjes së hipertensionit arterial ishte mjaft i shpejtë në dekadat e para të shekullit të 20-të; ndërkohë që shumë dogma të mëparshme u hodhën poshtë me argumenta shkencorë. Frank përdori termin 'hipertoni esenciale' në vitin 1925, ndërsa termi "sëmundja hipertensive vaskulare"', u prezantua më parë nga Janeway në vitin 1913, i cili e përshkroi më së miri dekursin e saj të ndryshueshëm. (15).

Bazat e matjes së presionit arterial, u themeluan nga punimet e Hejls, në 1733; përshkrimi i patologjisë së sëmundjes nga Morgagni 1761, Gull dhe Sutton, 1872, Gowers në 1876 dhe veçanërisht përshkrimi i toneve stetoskopike nga Nikolai Sergeyevich Korotkoff në 1905, të cilët mundësuan që teknika të përmirësohet deri në qasjen objektive (16-18). Kufizimi i kripës u përkrah, pasi roli i natriumit (Na) u

verifikua në vitin 1904. Ndërsa dieta me oriz e propozuar nga Kempner u popullarizua rreth viteve 1940. Tiocianati i natriumit ishte e para substancë kimike që u përdor në trajtimin e hipertensionit, nga mjekët Treupel dhe Edinger në vitin 1900. Kjo substancë ishte potencialisht toksike, dhe këto efekte rezultuan të shumta, kështu që shumë shpejt u braktis si alternativë trajtimi.

Kraus i kërkoi kirurgut Bruening për të kryer operacionin e parë të simpatektomisë për mjekimin e hipertensionit në vitin 1923 (2), ndërkohë që ndërhyrje më të avancuara u zhvilluan nga Peet në 1947; Smithëick në vitin 1953 dhe të tjerë mjekë në vitet në vazhdim. Simpatektomia kimike u prezantua më vonë si teknikë për trajtimin e hipertensionit arterial ku u përdorën kloruri i tetraetilamoniumit, hexametoniumi, dhe preparate të tjerë (19).

Zianis në vitin 1948, Burt dhe Graham në vitin 1950, Smirk po në vitin 1950, përdorën antimalarikun pentakinë, bretiliumin, dhe guanetidinën, për mjekimin e hipertensionit arterial. të gjitha të studiuara me rigorozitet nga Freis në periudhën 1947 - 1960 (20). Hidralazina, e cila përdoret ende edhe sot, u studjua nga Reubi në vitin 1949, veçanërisht në trajtimin e toksemisë (9). Zhvillimi më i rëndësishëm erdhi me futjen në skemat e mjekimit për herë të parë të diuretikëve oralë, si klorotiazidi, nga Freis dhe bashkëpunëtorët e tij në 1957; apo dhe diuretikëve merkurialë, të cilat rezultuan me një dështim të plotë (21).

Suksesi i klorotiazidit, stimuloi më tej kërkimet shkencore. Kështu në vitet 1960 u zbuluan beta-bllokuesit, të studjuar nga Prichard dhe Gillam. Puna e tyre u fokusua tek propranololi, ndërsa alfa-metil-dopa u studjua nga Oates, dhe bashkëpunëtorët në vitin 1960. Frenuesit e enzimës konvertazë, të cilët u zbuluan në fillim të viteve 1980, nga Ltiragh dhe ekipi i tij, ishin Kaptoprili dhe Enalaprili. Bllokuesit e kanaleve të kalçiumit u studiuan gjerësisht, ku mund të përmenden nifedipina, verapamili dhe preparate të tjera, të cilët fituan popullaritet në qarqet mjekësore (22-26).

Trajtimi i hipertensionit në vitet e ardhshme me siguri do të vazhdojë të jetë simptomatik. Fizio-patologjia e sëmundjes është studiuar gjerësisht; shkaqet e saj ende mbeten të panjohura në shumicën e rasteve, dhe madje edhe kur përcaktohet, sërisht dekursi i sëmundjes mund të mos të ndryshojë në një masë të përfillshme.

Gjenerata të reja barnash janë duke u studjuar. Ato premtojnë një ulje të ndjeshme të presionit të lartë të gjakut, me më pak efekte anësore, si edhe duke u përdorur nga një pjesë më e madhe e pacientëve. Ato do të kenë efekte të ndjeshme në përmirësimin e organeve të dëmtuar, si: hipertrofia e ventrikulit të majtë, dështimet renovaskulare, dëmtimet retinale, goditjet në tru, ndryshimet degjenerative arteriale, si edhe metabolizmin e lipideve dhe të glukozës (27-31).

Hipertensioni arterial është një sindromë progresive kardiovaskulare qe lind nga etiologji të ndërlikuara dhe të ndërlidhura. Shenjat e para të sindromës, shpesh janë prezente para se rritja e presionit të gjakut të bëhet e qëndrueshme, prandaj hipertensioni arterial nuk mund të përcaktohet vetëm nga kufijtë e presionit të gjakut. Rritja e tij është e lidhur ngushtë me anomali kardiake funksionale, strukturore dhe vaskulare që dëmtojnë zemrën, veshkat, trurin, enët e gjakut dhe organe të tjera, duke çuar në sëmundshmëri dhe vdekje të parakohshme (32, 33).

HTA është një sëmundje e çrregullimit vaskular i shkaktuar nga keqfunksioni i mekanizmave të kontrollit të presionit arterial (Sistemi Nervor Qendror, Sistemi Reninë-Angiotenzinë-Aldosteron, volumit të lëngjeve ekstravaskulare). Me fjalën hipertension arterial, zakonisht kuptohet një ngritje e presionit arterial mbi vlerat normale, si për presionin sistolik, ashtu dhe për atë diastolik.

Presioni i gjakut i referohet forcës që gjaku ushtron në muret e arterive gjatë qarkullimit të tij në enën e gjakut. Presioni përcaktohet nga forca dhe sasia e gjakut që pompohet nga zemra, si dhe niveli i rezistencës që ndesh gjaku në arteriere. Sa më shumë gjak të pompojë zemra dhe sa më të ngushta të jenë arteriet, aq më i lartë do të jetë presioni i gjakut. Organet kryesore të përfshirë në rregullimin e presionit të gjakut janë zemra, sistemi nervor simpatik dhe veshkat (34-36).

1.2. Epidemiologjia e hipertensionit arterial

Incidenca e HTA

Hipertensioni arterial (HTA) mbetet aktualisht semundja më e përhapur në botë, duke prekur mbi 1.5 miliard njerëz. Kjo frekuencë e HTA vjen duke u rritur edhe për shkak të rritjes së moshës mesatare të popullatës. HTA rezulton të jetë semundja që konsumon numrin më të madh të vizitave mjeksore dhe të përdorimit të barnave, e krahasuar me çdo semundje tjetër. Megjithë njohjen përfundimtare të rrezikut të HTA të pakontrolluar, në përgjithësi ai nuk mjekohet ose nuk kontrollohet ashtu si duhet.

Një nga arsyet e mosmjekimit është natyra asimptomatike e tij në 15-20 vjet, megjithë dëmtimin progresiv që shkakton semundja në organe. Megjithëse për shumicën, HTA-të mbeten të panjohura për shkak të mekanizmave specifikë, është provuar plotësisht se kjo sëmundje, edhe nëse nuk parandalohet, mund të ngadalsohet mjaft në progresin e saj patologjik.

Përcaktimi i HTA është deri diku arbitrar dhe merr në konsideratë një shifër që e dyfishon “rrezikun afatgjatë” tek njeriu. Kështu, përcaktimi më i saktë i HTA do të ishte:

“HTA është niveli kur përfitimet nga veprimet kundër tij (minus rrezik dhe kosto) e tejkalojnë rrezikun dhe koston (minus mosveprimi) e mosveprimit ndaj tij”.

Prevalenca e HTA

Prevalenca e HTA, megjithëse gjithmonë e lartë, është e ndryshme në vende të ndryshme. Sipas studimeve të ndryshme ajo varion nga 27%, në Kanada, deri në 55%, në Gjermani. Prevalenca e HTA rritet me moshën dhe, duke iu referuar shifrave të qendrave të kontrollit dhe parandalimit të sëmundjes në SHBA, ajo varion nga 6.7% në moshat 20-30 vjeç, në më tepër se 65% mbi 65 vjeç. Raporti i prevalencës së HTA

me gjininë nuk sjell diferenca të rëndësishme midis dy gjinive. Megjithatë vërehet një prevalencë më e lartë e tij tek meshkujt e moshave të reja, në raport me femrat, diferencë kjo që vjen duke u zbehur deri sa zhduket fare rreth moshës 50 vjeç e lart. Një dukuri interesante është prevalenca e ndryshme e HTA në rraca të ndryshme. Studimet amerikane kanë vërtetuar se prevalenca e HTA tek afroamerikanët (40.5%) është mjaft më e lartë sesa tek "të bardhët" hispanike (25.1%) apo jo-hispanikë (27.4%). Studimet e fundit, kanë vërejtuar tendencën në rritje të kësaj sëmundje, dhe parashikojnë që prevalenca e HTA do të rritet rreth 60% në 25 vitet e ardhshme (37).

Edhe në vendin tonë janë kryer studime të rëndësishme lidhur me prevalencën e HTA në popullatë. Në një studim që kontrolloi random, pra në mënyrë të rastësishme, popullatën e qytetit të Tiranës, disa vite më parë, prevalenca e HTA rezultoi rreth 22.5%. Edhe sipas të dhenave të ketij studimi, prevalenca e HTA rritej me moshën (3.7% në moshën nën 45 vjeç deri në 40.1% mbi 45 vjeç). Në një studim tjetër u studjua prevalenca e HTA në të sëmurët me SAK, të shtruar ne QSU Tirane. Ajo rezultoi rreth dyfishi i prevalencës së HTA të popullatës në tërësi, rreth 55.6%, duke vërtetuar edhe një herë rolin e kësaj sëmundje si një faktor i rëndësishëm rreziku për SAK. Kjo prevalencë rezultonte më e lartë tek femrat në raport me meshkujt (72.9% *vs* 50%) në këtë popullatë dhe po ashtu ajo rritej gradualisht me moshën në të dyja gjinitë. Ajo e ruante gjithmonë diferencën, pra supermacinë, në thonjëza, të femrave në raport me meshkujt. Në të sëmurët me SAK, prevalenca e HTA ndryshonte sipas statusit civil (beqarë 33%, të martuar 54% dhe të divorcuar 69.9%), si edhe statusit të punësimit (i punësuar 59% dhe i papunë 42%). Nuk u vunë re diferenca domethënëse në grupet e ndryshme sipas nivelit të shkollimit (57% të shkolluar deri 8 vjet, dhe 53% të shkolluar > 8 vjet), lloji i punësimit (punëtor 55%, fermer 54% dhe pensionist 58%) apo origjina e lindjes nga vinte popullata (fshat 57% dhe qytet 54%).

1.3. Fiziologjia patologjike e hipertensionit arterial

Tensioni i lartë i gjakut, i quajtur ndryshe hipertension, është tensioni i lartë i gjakut në arterie. Instituti Kombëtar për Shëndetësi dhe Përsosmëri Klinike (NICE) e përcakton Hipertensionin si presionin e gjakut mbi 140/90 mmHg. Ekzistojnë dy shkaqe për avancimin e presionit të lartë të gjakut: I pari është i lidhur me faktin se zemra pompon gjakun me forcë, ndërsa arsyeja e dytë është e lidhur me shtrëngimin e arteriolave si rrjedhim fluksi i gjakut do të ushtrojë më shumë presion në to. Në këtë mënyrë organizmi familjarizohet me gjendjen hipertensive për disa kohë, por në stadin final zemra rezulton e zgjeruar dhe kjo gjendje quhet hipertrofi e zemrës. Hipertrofia kardiake është shkaku kryesor i sëmundjeve kardiake (38). Kjo rritje e qëndrueshme në vlerat e presionit të gjakut ndikon në punën e arterieve dhe arteriolave në organe të ndryshme; të tilla si: truri, veshka, zemra dhe retina e syrit.

Dy komponentë të cilët janë përdorur për klasifikimin e presionit të gjakut janë respektivisht: presioni sistolik dhe presioni diastolik. Kur matim presionin e

gjakut fillimisht lexohet presioni sistolik, ndërsa presioni diastolik lexohet si vlera e dytë. Të dy këto presione, sistolik edhe diastolik, kanë rëndësinë e tyre. Grupmosha të ndryshme janë të prekur nga hipertensioni dhe pasojat e tyre varen nga fakti nëse kanë të ngritur presionin sistolik, apo atë diastolik, ose të dy së bashku. Presioni i pulsit është matja e tretë, i cili që është parashikuesi kryesor i shkallës së avancimit të sëmundjes. Presioni i gjakut regjistrohet me sfigmomanometër dhe njësia e saj është milimetër Mërkur (mmHg). Udhëzimet për hipertensionin e të rriturve propozojnë tre kategori: normal, prehipertensiv dhe hipertensiv (39, 40).

Në të rriturit 'normalë', presioni gjakut duhet të jetë 120/80 mmHg, ose më i ulët. Hipertensioni është zakonisht i pranishëm kur tensioni i gjakut kap vlerat 140/90 mmHg ose më të larta. Leximi i sipërm 140 mmHg është presioni sistolik, ndërsa leximi i poshtëm 90 mmHg është ai diastolik. Në grupin pre-hipertensiv vlerat e tensionit janë 120-139 mmHg / 80-89 mmHg, duke treguar një tendencë të lartë ndaj presionit sistolik të gjakut (41,42).

Presioni sistolik i gjakut: është forca e ushtruar mbi muret e arterieve, kur zemra kontraktohet për të pompuar gjakun. Presioni sistolik i lartë është përgjegjës për komplikime në organe të ndryshme, të tilla si zemra, enët e gjakut dhe veshkat. Ai është gjithashtu një nga shkaqet më të zakonshëm të vdekjeve në të individë të rritur me moshë mesatare apo të vjetër.

Presioni diastolik i gjakut: tregon forcën mbas relaksimit të zemrës për të lejuar gjakun të hyjë në të. Presioni i lartë në diastole është një tregues i rëndësishëm i insuficiencës kardiake apo insultit cerebral në moshat e reja dhe të rritura.

Presioni i pulsit: është dallimi ndërmjet presionit sistolik dhe atij diastolik të gjakut. Ai matet duke zbritur vlerën e presionit sistolik nga ai diastolik. Presioni i pulsit tregon dëmtimin dhe ngurtësinë e arterieve. Vlerat e larta të tij tregojnë më shumë dëme dhe ngurtësi (rixhiditet) në arterie. Është vërtetuar se vlera e lartë e presionit të pulsit është tregues i sëmundjeve kardiake sidomos në moshën e tretë. Në individët mbi 45 vjeç çdo rritje me 10 mmHg e rrit rrezikun e dëmtimit në tru me 11%, në sëmundjet kardiovaskulare me 10%, dhe vdekshmërinë e përgjithshme me 16%. Në gjeneratat e reja të të rriturve rreziku është më i lartë (43).

Klasifikimi i Hipertensionit

Tensioni i lartë i gjakut klasifikohet në mënyra të ndryshme. Një prej klasifikimeve është prezantuar më poshtë:

- ✓ *Hipertensioni esencial* - përafërsisht 90% e rasteve hipertensive i përkasin hipertensionit esencial. Shkaku është ende i panjohur. Kjo është arsyeja pse ai quhet edhe idiopatik apo hipertension kryesor (primar). Shkaku mund të vijë nga procese komplekse në sistemet kryesore të organizmit dhe organe si p.sh: enët e gjakut, zemra, veshkat, nervat dhe hormonet.
- ✓ *Hipertensioni i mesëm* - është përgjegjës i 5% të rasteve të hipertensionit (44-51). Faktorët përgjegjës për hipertensionin e mesëm janë:

A. Hipertensioni i veshkave
B. Hipertensioni induktuar në shtatzëni (HISH)
C. Sindromi Cushing
D. Hipertensioni malinj
E. Drogat
F. Koartacioni i aortës

1.4. Lipoproteinat

Lipoproteinat janë makromolekula të ndërtuara nga lipidet dhe proteinat. Proteinat janë të lidhura me strukturat lipidike ose derivatet e tyre në mënyrë kovalente ose jo-kovalente (lidhje-H). Transportuesit e proteinave strukturore, enzima të ndryshme, antigjene, toksina dhe aderenca membranore njihen si lipoproteina. Lipoproteinat ndahen në dy grupe: lipoproteina me densitetit të lartë (HDL) dhe lipoproteina me densitet të ulët (LDL). Këto të dytat lehtësojnë procesin e transportimit të yndyrnave në sistemin e qarkullimin e gjakut, proteinave transmembranore të mitokondrive, kloroplastit, si edhe të lipoproteinave bakteriale (52-57).

Funksioni

Molekulat e lipideve, dhe kolesterolit që bën pjesë në to, kanë natyrë hidrofobe. Transportimi i tyre nëpërmjet gjakut nuk mund të realizohet në mënyrë difuze, për vetë faktin se gjaku është një mjedis ujor, pra ka natyrë hidrofile. Këto molekula mund të treten normalisht në grimcat lipoproteinike, dhe në këtë mënyrë do të mundësohet transporti i tyre në të gjithë organizmin. Vetë kolesteroli është një strukturë që merr pjesë në ndërtimin e qelizave të organizmit. Ai krijon membranat e shumëfishta që qelizat i përdorin, për të kontrolluar elementët e tretur në fazën ujore në mjedisin e brendshëm për të kompletuar sistemet e tyre proteino-enzimatike si dhe strukturën e brendshme (58-61).

Grimcat lipoproteinike në strukturën e tyre kanë grupe hidrofilike të kolesterolit, fosfolipideve, dhe apoproteinave të drejtuara nga sipërfaqja e jashtme. Ato i ndihmojnë këto molekula të bëhen të tretshme në mjedisin me kripëra të tretura në gjak. trigliceridet dhe esteret e kolesterolit transportohen në brendësi të grimcës lipoproteinike, duke u izoluar nga faza ujore nëpërmjet shtresave të njëfishta të fosfolipideve dhe apoproteinave. Ndërveprimi i proteinave që formojnë sipërfaqen e grimcave me: (a) enzimat në gjak; (b), me njëra-tjetrën dhe (c) me proteina specifike në sipërfaqet e qelizave; përcaktojnë nëse trigliceridet dhe kolesteroli duhet të shtohen ose të largohen nga grimcat transportuese lipoproteinike. Përsa i përket zhvillimit të atheromas dhe situatës ‘avancim’ përkundër ‘regres’, çështja kryesore mbetet mekanizmi i transportit të kolesterolit, dhe jo përqendrimi i kolesterolit në vetvete (62,63).



Figura1. Përmbledhje e metabolizmit të lipopoteinave. Ky është shndërrimi i VLDL në IDL dhe më tej në një fazë të dytë në LDL duke humbur molekula trigliceridesh, ai gjithashtu njihet si skema degradimit lipoproteinik.

Table 1: Karakteristikat e lipoproteinave

	Kilomikronet	**VLDL**	**LDL**	**HLD**	**FFA**
Densiteti (g/L)	< 0.95	0.95-1.006	1.019-1.063	1.063-1.121	1.28
Diametri (nm)	500	70	25	15	-
Mobiliteti elektroforetik	Origjinë	Pre-beta	Beta	Alfa	Albuminë
% përbërje					
Proteina	2	10	22	30-60	99
TAG	83	50	10	8	0
Fosfolipide	7	18	22	20-30	0
Kolesterol	8	22	46	10-30	0
FFA	0	0	0	0	1
Apoproteina	A, B-48, C-II, E	B-100, C-II, E	B-100	A-I,C, E	Albuminë
Funksioni transportues	TAG nga pankreasi në muskuj dhe inde adipoz	TAG nga mëlçia në muskuj	Kolesteroli nga mëlçia në zemër	Koleseroli nga zemra në mëlçi	FFA nga indi adipoz në muskuj

Klasifikimi i lipoproteinave

Në bazë të funksioneve dhe densitetit të tyre lipoproteina klasifikohen si më poshtë.

- *Kilomikronet*- transportojnë trigliceridet nga mëlçia në muskujt skeletorë, dhe në indin dhjamor.

- *Lipoproteina me densitet shumë të ulët* (VLDL) - mbartin trigliceridet endogjenë nga mëlçia në indin dhjamor.
- *Lipoproteina me densitet të ndërmjetëm* (IDL) - janë një grupim i ndërmjetëm mes VLDL dhe LDL, të cilat zakonisht nuk detektohen në gjak (64-67).
- *Lipoproteina me densitet të ulët* (LDL) - mbartin kolesterolin nga mëlçia në qelizat e organizmit. Ne u referohemi si lipoproteina të 'kolesterolit të keq'.
- *Lipoproteina me densitet të lartë* (HDL) - mbledhin kolesterolin nga indet e organizmit, dhe e sjellin atë sërish në mëlçi. Ndonjëherë HDL-ve u referohemi si lipoproteina të "kolesterolit të mirë" (68).

Tabela 2. Klasifikimi i lipoproteinave bazuar në vlerën e densitetit.

Densiteti (g/mL)	Klasa	Diametri (nm)	Proteina (%)	TC (%)	Fosfolipide (%)	Trigliceride (%)
1.063	HDL-C	5-15	33	30	29	8
1.019-1.063	LDL-C	18-28	25	50	21	4
1.006-1.019	IDL-C	25-50	18	29	22	31
0.95-1.006	VLDL-C	30-80	10	22	18	50
< 0.95	Kilomikrone	100-1000	< 2	8	7	84

Kolesteroli Total

Kolesteroli Total (TC) është i pranishëm në membranat qelizore dhe transportohet në plazmën e gjakut. Ai është një komponent thelbësor i membranave qelizore të gjitarëve, i cili siguron përshkueshmërinë dhe rrjedhshmërinë e duhur në membranë. Kolesteroli klasifikohet si një sterol, i cili është një ndërthurje e familjeve të steroideve dhe alkooleve. Edhe pse kolesteroli është vendimtar për jetën, nivele të larta të tij në sistemin e qarkullimit të gjakut janë të lidhur me aterosklerozën. Ai është prezent në dietë, dhe riciklohet në organizëm nëpërmjet ri-absorbimit biliar në traktin e tretjes. Kolesteroli ndihmon organizmin për të ndërtuar qelizat dhe për të prodhuar hormone. Nivele të tepërta në gjak mund të çojë në depozitimin në muret arteriale, duke formuar pllaka. Këto pllaka shtojnë mundësinë e një ataku kardiak ose goditje cerebrale (69, 70).

Kolesterol-lipoproteinat me densitet të lartë

Kolesterol-lipoproteinat me densitet të lartë (HDL-C) janë një prej 5 grupeve më të mëdha të lipoproteinave (kilomikronet, VLDL-C, IDL-C, LDL-C, dhe HDL-C). Ato lehtësojnë transportin e lipideve në gjak, të tillë si kolesteroli dhe trigliceridet. Në

personat e shëndetshëm, përafërsisht 30% e kolesterolit mbartet nga HDL-të. Ekziston hipoteza që HDL mund të largojë kolesterolin nga atheroma brenda arterieve dhe ta transportojë atë në mëlçi për ri-përdorim dhe ekskretim (jashtëqitje). Pra kjo është arsyeja kryesore pse HDL-kolesteroli shpesh quhet "kolesteroli i mirë". Nivele të ulëta të HDL-C (më pak se 40 mg/dL), rritin rrezikun për sëmundje të zemrës, ndërsa një nivel i lartë i HDL-C ndihmon në mbrojtjen kundër sëmundjeve kardiovaskulare. Gjatë përcaktimit të kolesterolit, prania e grimcave të HDL-C nënkupton siguri të shtuar për shëndetin e sistemit kardiovaskular të organizmit, në kontrast me "kolesterolin e keq" LDL (71,72).

HDL-C mbart një numër grupesh lipidike dhe proteinash, shumë nga të cilat kanë përqendrim shumë të ulët, por janë biologjikisht shumë aktive. Për shembull, HDL-C, proteinat e saj dhe komponentët e lipideve ndihmojnë për aktivizimin e endotelit, inflamacionin, agregimin e trombociteve apo koagulim dhe ulje të statusit të oksidimit. Të gjitha këto cilësi mund të shtohen në aftësinë e HDL-C për tu mbrojtur nga ateroskleroza (73).



Figura 2. Përmbledhje e metabolizmit lipoproteinik. Niveli I HDL në serum është i lidhur në relacion të zhdrejtë me rastet e infraktit të miokardit. Meqënëse është me natyrë “anti-aterogjenike” ose “protektive” HDL është e njohur si “kolesteroli i mirë” në fjalorin e përditshëm.

Kolesterol-lipoproteinat me densitet të ulët

Kolesterol-lipoproteinat me densitet të ulët (LDL-C) janë një lloj i lipoproteinave që transferojnë trigliceridet dhe kolesterolin nga mëlçia në indet periferike. Ngjashëm me të gjithë lipoproteinat, LDL-C lehtëson lëvizjen e

trigliceridеve dhe kolesterolit në fazën ujore të sistemit të qarkullimit të gjakut. Gjithashtu, LDL-C kontrollon prodhimin e kolesterolit në këto qendra (74). Në kontrollet mjekësore ai shpesh rezulton si pjesë e testit të kolesterolit në gjak; në të cilin nivelet e larta të LDL-kolesterolit mund të jenë një shenjë paralajmëruese e çrregullimeve në organizëm si për shembull sëmundjet kardiovaskulare. Nganjëherë ai quhet kolesteroli i keq, në kontrast me HDL-C, i cili referohet si kolesteroli i mirë. Çdo grimcë LDL-C ka një molekulë të vetme apolipoproteinë B-100, e cila qarkullon acidet yndyrore, duke i shndërruar ato të tretshëm në fazën ujore. Gjithashtu, LDL-C ka një qendër shumë-hidrofobike të përbërë nga një lloj acid yndyror, me disa lidhje të pangopura, i njohur si *linoleat,* si dhe rreth 1500 molekula të esterifikuara kolesteroli. Kjo qendër rrethohet nga një mburojë fosfolipidesh dhe kolesteroli të pa-esterifikuar, si dhe një molekulë e vetme apolipoproteinë B-100 e madhe. Diametri i grimcave LDL-C varion rreth 22 nm dhe masë prej rreth 3 milion Dalton. Meqënëse grimcat e LDL-C kanë një numër të ndryshueshëm të molekulave të acideve yndyrore, ato në realitet rezultojnë me masë dhe madhësi të variueshme (75).

Kolesterol-lipoproteinat me densitet shumë të ulët

Kolesterol-lipoproteinat me densitet shumë të ulët (VLDL-C) janë një lloj i lipoproteinave të sintetizuara në mëlçi. VLDL-C ndihmojnë kolesterolin dhe trigliceridet duke i transportuar në fazën ujore të sistemit të qarkullimit të gjakut. VLDL-C grumbullohet në mëlçi nga kolesteroli dhe apolipoproteinat. VLDL-C modifikohen në gjak në lipoproteina me densitet të ulët. Diametri i grimcave të VLDL-C varion në intervalin 30-80 nm. Kilomikronet transportojnë produktet ekzogjenë (dietike), ndërsa komponimet endogjenë transportohen nga kolesterol-VLDL. VLDL-C transportojnë fosfolipidet endogjene, kolesterolin, trigliceridet dhe esteret e kolesterilit. Ato luajnë një rol në mekanizmin e transportit të brendshëm të lipideve në organizëm. Nivelet e VLDL-C janë të lidhura me nivelet e larta të aterosklerozës dhe janë të lartë sistemet metabolike dhe në një numër sëmundjesh (76).

Trigliceridet

Trigliceridet, si përbërësit kryesorë të kolesterol-lipoproteinave me densitet shumë të ulët dhe kilomikroneve, luajnë një rol të rëndësishëm në metabolizëm; qoftë si burim energjie apo transportues të yndyrnave dietike. Nga metabolizmi i plotë i tyre në organizëm çlirohet energji (9 kcal/g), më lartë krahasuar me energjinë e çliruar gjatë metabolizmit të proteinave dhe karbohidrateve (4 kcal/g). Në zorrën e hollë, trigliceridet hidrolizohen në acide yndyrore dhe glicerinë, të cilat më tej transferohen në qelizat e mukozës së zorrës. Trigliceridet rindërtohen në enterocite nga fragmentet përbërës dhe paketohen së bashku me proteinat dhe kolesterolin duke formuar kilomikronet. Më tej këto ekskretohen nga qelizat, mblidhen nga sistemi limfatik dhe transportohen në enët e mëdha në afërsi të zemrës para se të përzien në gjak. Inde të

ndryshme mund të lidhin kilomikronet dhe të çlirojnë trigliceridet të cilat mund të përdoren si burim energjie. Qelizat e mëlçisë mund të prodhojnë dhe depozitojnë trigliceridet dhe lipidet. Kur organizmi ka nevojë për acide yndyrore si burim energjie, hormoni glukagon realizon hidrolizën enzimatike të triglicerideve nga lipazat, të cilat janë sensitive ndaj këtij hormoni duke çliruar acidet yndyrore. Truri nuk mund të përdorë acidet yndyrore si burim energjie, përveç rasteve kur ato janë shndërruar në ketone (helika Lynen). Glicerina e triglicerideve mund të shndërrohet në glukozë, nëpërmjet procesit të glukoneogjenezës, për të furnizuar trurin me energji.

Transporti i triglicerideve nuk mund të realizohet përmes membranave qelizore me anë të difuzionit të lirë. Enzima të veçanta në paretet e enëve të gjakut, të quajtura lipaza-lipoproteinike duhet të hidrolizojnë trigliceridet në glicerinë dhe acide yndyrore. Nivelet e larta të triglicerideve në qarkullimin e gjakut janë të lidhura me aterosklerozën në organizmin e njeriut, e cila rrit rrezikun e insultit cerebral dhe të sëmundjeve të zemrës. Megjithatë, deri më tani ndikimi relativ negativ i rritjes së përqendrimit të triglicerideve krahasuar me atë të raportit *LDL:HDL* është i paidentifikuar. Rreziku mund të llogaritet pjesërisht nga një korelacion invers ndërmjet nivelit të triglicerideve dhe nivelit të HDL- C (77).



Figura 3. Absorbimi i acideve yndyrore. Acidet yndyrore me varg të gjatë absorbohen në muret e zorrëve të holla, ku ata I nënshtrohen një reaksioni riesterifikimi në kilomikrone dhe hyjnë në nyjet limfatike. Acidet yndyrore me varg të shkurtë abosrbohen drejtpërdrejt në enet e gjakut, pikërisht në kapilarë. Acidet biliare riabsorbohen në venën portale.

Apolipoproteinat

Apolipoproteinat janë një lloj proteinash që lidhen me lipidet. Ato formojnë lipoproteina, të cilat lidhin yndyrnat dietike nëpërmjet qarkullimit të gjakut. Yndyrnat dietike treten në zorrë dhe transportohen në mëlçi. Mëlçia gjithashtu i sintetizon vetë yndyrnat. Yndyrnat depozitohen në qelizat yndyrore të quajtura adipocite. Yndyrnat metabolizohen për vetë faktin se janë thelbësore si burim energjie në zemër, muskujt skeletorë, dhe organe të tjera. Tek nënat e sapolindura ata sekretohen nga gjiri në qumësht.

Pjesa vajore e lipoproteinave nuk është e tretshme në ujë, por për shkak të veprimit amfipatik (i ngjashëm me detergjentët), apolipoproteinat i ndihmojnë ato të treten. Apolipoproteinat shërbejnë, gjithashtu si kofaktorë enzimatikë, ligande receptorësh dhe transportues të lipideve që kontrollojnë metabolizmin e lipoproteinave dhe thithjen e tyre në inde. Ka gjashtë klasa kryesore të apolipoproteinave dhe një numër nën-klasash, të cilat janë rënditur në vijim:

i. A (apo A-I, apo A-II, apo A-IV, dhe apo A-V)
ii. B (apo B48 dhe apo B100)
iii. C (apo C-I, apo C-II, apo C-III, dhe apo C-IV)
iv. D
v. E
vi. H

Tashmë janë vlerësuar me qindra polimorfizma gjenetikë të apolipoproteinave. Disa prej tyre mund të ndryshojnë funksionin dhe strukturën e tyre (78). Prodhimi i tyre është i kontrolluar kryesisht nga pjesa yndyrore e tyre në zorrët e holla. Sinteza e apolipoproteinave në mëlçi përcaktohet nga faktorë të shumëfishtë. Këtu përfshihen hormonet (estrogjenet, glukagoni, insulina, androgjenet, tiroksina), konsumi i alkoolit dhe medikamente të ndryshëm si statinat, niacina, etj.

Lipoproteina (a)

Lipoproteina (a) [Lp a] është një nënklasë e lipoproteinave. Studime të shumta kanë pohuar se Lp (a) përbën një rrezik evident për çrregullimet aterosklerotike, si ataku kardiak dhe sëmundjet koronare të zemrës.

Lipoproteina (a) përbëhet nga një LDL-C në formën e grimcës dhe apolipoproteina (a) specifike, e cila është e lidhur në mënyrë kovalente me apoB të LDL-C-së (grimcore). Nivelet plazmatike të Lp (a) janë shumë herë të trashëguara dhe shpesh është e kontrolluar nga gjeni i apolipoproteinë (a). Nivelet e larta të Lp (a) në gjak janë një kërcënim për sëmundjen cerebrovaskulare (CVD), sëmundjen koronare të zemrës (CHD), trombozat, arteriosklerozën dhe atakun kardiak. Nivelet Lp (a) mund të ndikohen nga stadet e sëmundjes, por janë pak të ndikueshëm nga aktiviteti fizik, dieta apo faktorë të tjerë mjedisorë. Vlerat e Lp(a) të larta parashikojnë rrezikun ndaj një arterioskleroze të hershme ashtu si LDL-C e lartë, por në

aterosklerozën e avancuar, Lp(a) është një faktor rreziku i pavarur nga LDL-C-ja. Lp (a) tregon një kërcënim për koagulim të pllakave të trombociteve.

Tabela 2. Niveli i kolesterolit dhe trigliceridеve në gjak

Kolesteroli Total	Norma	1 2	Më pak se 200 mg/dL Më pak se 5.2 mmol/L
	Kufiri	3 4	200–239 mg/dL 5.2–6.2 mmol/L
	I Lartë	5 6	240 mg/dL ose më lart 6.2 mmol/L ose më lart
Kolesteroli HDL	I lartë *norma	7 8	Më shumë se 60 mg/dL Më shumë se 1.6 mmol/L
	I pranueshëm	9 10	40–60 mg/dL 1.0–1.6 mmol/L
	I ulet *nën normë	11 12	Më pak se 40 mg/dL Më pak se 1.0 mmol/L
Raporti Kolesterol total/HDL	Norma	13	5:1 ose më pak
	Jo në normë	14	Më shumë se 5:1
Kolesteroli LDL	Optimal:	15 16	Me pak se 100 mg/dL Me pak se 2.6 mmol/L
	Thuajse optimal:	17 18	100–129 mg/dL 2.6–3.4 mmol/L
	Kufiri	19 20	130–159 mg/dL 3.4–4.1 mmol/L
	I Larte:	21 22	160–189 mg/dL 4.1-4.9 mmol/L ose më lart
	Shumë i lartë:	23 24	190 mg/dL ose me lart 4.9 mmol/L ose me lart
Kolesteroli VLDL	Optimal:	25 26	Më pak se 130 mg/dL Më pak se 3.4 mmol/L
	Kufiri i lartë:	27 28	140–159 mg/dL 3.4–4.1 mmol/L
	I lartë:	29 30	160 mg/dL ose me lart 4.1 mmol/L ose me lart
Trigliceridet	Normal:	31 32	Më pak se 150 mg/dL Më pak se 1.7 mmol/L
	Kufiri:	33 34	150–199 mg/dL 1.7–2.3 mmol/L
	I lartë:	35 36	200-499 mg/dL 2.3-5.6 mmol/L
	Shume I lartë:	37 38	500 mg/dL ose më lart 5.6 mmol/L ose më lart

Testet laboratorike të përdorura për vlerësimin e nivelit të lipideve në gjak

Testet e kolesterolit dhe trigliceridеve janë analiza gjaku që masin sasinë e përgjithshme të substancat yndyrore në gjak. Analiza e lipoproteinave (profili i lipoproteinave ose i lipideve) vlerëson nivelet e kolesterolit total në gjak, kolesterol-HDL, kolesterol-LDL, dhe trigliceridеve. Norma, limiti i normës dhe nivelet e larta të lipoproteinave janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Raporti *HDL:LDL* bazuar në shkallën e rëndimit të sëmundjes është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3. Shpërndarja e niveleve të HDL: LDL sipas ashpërsisë së tyre

Niveli i Rrezikut	Meshkuj	Femra
Rrezik shumë i ulët	3.4	3.3
Rrezik i ulët	4.0	3.8
Rrezik i përfillshëm	5.0	4.5
Rrezik i moderuar	9.5	7.0
Rrezik i lartë	>23	>11

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë nivelet optimale, ato në kufi, dhe nivelet e larta për çdo përbërës të lipoproteinës të propozuar nga Institute Ndërkombëtarë të rëndësishëm.

Tabela 4. Nivelet e vlerave optimale, në kufi dhe të larta të çdo komponenti

Lipoproteina	Optimal	Kufiri	Rrezik i lartë
Kolesterol-LDL (mg/dL)	<100	130–159	160+
Kolesterol-HDL (mg/dL)	>60	35–45	<35
Trigliceridet (mg/dL)	<150	150–199	>200
Kolesteroli Total (mg/dL)	<200	200–239	>240
Raporti *Kolesterol / HDL*	<4	5	>6

Komplikacionet e Hipertensionit arterial

Infarkti është një komplikacion i rëndësishëm i hipertensionit. Ai shkaktohet nga presionet e larta në sistole dhe diastole. Tensioni sistolik i gjakut është me delikat. Gratë kanë shkallë rrezikshmërie dy herë më të lartë. Komplikime të tjera të hipertensionit janë: hipertrofia e ventrikulit të majtë, sëmundjet ishemike të zemrës, dështimi kardiak, sëmundjet progresive renale, sëmundjet vaskulare, retinale dhe disekimi i aneurizmës (79-84).

Prognoza

Faktorët e rrezikut që ndikojnë në prognozë janë:

1. Mundësia e një incidenti kardiovaskular për çdo rritje presioni të gjakut e lidhur me moshën; kontrolli i hipertensionit është kryesisht i dobishem në pacientët e moshuar.
2. Diabeti, profili i çrregullt i lipideve dhe pirja e duhanit janë faktorët kryesorë që mund të shkaktojnë sëmundje të zemrës. Nëse dy ose më shumë faktorë rreziku janë të pranishëm në pacientët me hipertension, rreziku i semundjeve të zemrës rritet. Pra efekti në fjalë është sinergjik dhe jo aditiv, ku mundësia e çrregullimeve kardiovaskulare është më e lartë krahasuar me shumën e rreziqeve individuale të individit.
3. Hipertrofia e ventrikulit të majtë në EKG mbart një prognozë të varfër.

1.5. Hipertensioni i induktuar gjatë shtatzënisë

Ndikimi i shtatzënisë në hipertension ka qenë i njohur që në lashtësi. Hipertensioni i induktuar gjatë shtatzënisë (HISH) njihej edhe nga grekët e lashtë. Ata besonin që simptomat e shfaqura si shurdhim, përgjumje dhe dhimbje koke në gratë shtatzëna ishin shenja jo të mira (85).

Në librat autentike të Hipokratit nuk gjejmë asnjë shpjegim për këtë sëmundje. Në librin e *Komentar mbi Aforizmat e Hipokratit* të publikuar nga Gallen nuk rezulton se ai ishte i familjarizuar me karakteristikat agresive në gratë shtatzëna. St. Gall një mjek mjaft i njohur në shekullin e dhjetë në mesjetë tregon se ndaj tij u inskenua një situatë ironike (86). Ai ishte duke ekzaminuar Dukën e Bavarisë, një aristokrat i rëndësishëm, i cili bëri një shaka kur zëvendësoi urinën e tij me urinën e një gruaje, e cila ishte shtatzënë. Kleriku i lartë pas kryerjes së ekzaminimeve bëri deklaratën e trishtueshme se Duka do të lindte një fëmijë. Kjo ngjarje është ndoshta prova e parë e gjetjes se proteinave në urinën e grave shtatzënë. Në fakt, përshkrimi teknik i HISH filloi tërthorazi në shekullin e 17-të (87).

Blundell dhe autorë të tjerë dokumentuan simptomat e HISH. Në 1840, Rayer zbuloi prezencën e proteinave në urinën e tri grave shtatzëna me edemë. Gjithashtu, Simpson dhe Llozi veçmas prej njeri-tjetrit, në vitin 1843 zbuluan proteina në urinën e grave shtatzëna. Praktikuesit e hershëm konstatuan presionin e ngritur të gjakut tek gratë me HISH, nëpërmjet kontrollit të pulsit. Në vitin e largët 1884, Vinay përdori një sfigmomanometër primitiv. Ai vlerësoi se presionet e gjakut 160-200 mmHg në gratë shtatzëna janë të shoqëruar me prezencë të proteinave në urinë (88, 89).

Vlera e presionit të gjakut konsideroheshin normale deri në 160 mmHg. Ishin Vaques dhe Nobecourt në vitin 1897 ata që zbuluan diagonzën e hipertensionit eklamptik, por ato besonin që kishin vërtetuar ekzaminimin e Vinay.

Rreth 2-3% e shtatzënive janë të shoqëruara me komplikacione të presionit të lartë të gjakut, i cili në vetvete është një problem i shpeshtë shëndetësor gjatë shtatzënisë. Presioni i gjakut më i lartë se 140/90 mmHg para shtatzënisë, ose deri në javën e 20 të shtatzënisë, quhet hipertension kronik. Hipertensioni pas javës të 20 të shtatzënisë në një grua me edemë dhe proteinuri pa histori të mëparshme të hipertensionit, quhet shtatëzani me hipertension të induktuar.

Kur çrregullimi është i shoqëruar me proteinuri, ai quhet eklampsi-preeklamptike/ toksemi gjaku, dhe kur është i pranishëm pa proteina në urinë, quhet hipertension kalimtar ose hipertension gestacional. HISH është i pranishëm në rreth 5% të shtatzënive, në 10% të grave shtatzëna për herë të parë, dhe 20 deri në 25% të grave me histori të mëparshme të hipertensionit kronik. Presioni i ngritur i gjakut në shtatëzani është shkaku kryesor i sëmundshmërisë së fetusit dhe mortalitetit të tij (90, 91).

Çregullimet hipertensive komplikojnë 10-20% të gravidancave dhe përbëjnë shkakun kryesor te morbiditetit dhe mortalitetit si maternal ashtu edhe fetal. Preeklampsia shfaqet afërsisht në 5% te te gjithe gravidancave, 10% tek primiparet dhe 20-25% tek grate me histori per hipertension arterial kronik (HTA). Hipertensioni i barres shfaqet ne 6% te gravidancave. Eklampsia komplikon 1 ne 2000 gravidanca.

Klasifikimi HTA gravidar klasifikohet në 4 tipe:

1. Hipertension kronik
2. Preeklampsi e mbivendosur mbi një HTA kronike
3. Preeklampsi-eklampsi
4. Hipertension gravidar

HTA kronike (ose HTA preekzistues) përkufizohet si tension arterial sistolik (TAS) > 140mmHg dhe tension arterial diastolik (TAD) > 90mmHg, para ose gjatë 20 javëve të para të gravidances dhe është i pranishëm edhe 12 javëve pas lindjes. Mund të jetë primar (HTA esencial) ose sekondar (sëmundje renale, diabet, LED). Ai mund te shoqërohet edhe me proteinuri. Preeklampsia e mbivendosur mbi një HTA kronik diagnostikohet kur gruaja me HTA preekzistues zhvillon një proteinuri mbas 20

javëve të shtatzënisë. Gratë me HTA dhe proteinuri preekzistuese konsiderohen pre-eklamptike nëse paraqesin një përkeqësim të situatës hipertensive (TA>160/110) në gjysmën e dytë të barrës, veçanërisht nëse shoqerohen me simptomat e trombocitopenisë dhe rritje të enzimave hepatike (92).

Preeklampsi-eklampsia

Preeklampsia prezanton një sindromë, e cila përkufizohet si manifestimi i HTA dhe proteinurisë për herë të parë në një grua mbas 20 javëve të para të gravidancës, me histori normotensive të mëparëshme. Eklampsia i referohet shfaqjes së një ose me shumë konvulsioneve dhe/ose komës në kuadrin e preeklampsisë edhe në mungesë të konditave të tjera neurologjike (93, 94).

Kur tensioni i gjakut rritet në shtatzëni me nivel të lartë të proteinave në urinë, ai quhet pre-eklampsi. Toksemia pre-eklamptike është në fakt një sindromë i shenjave dhe simptomave.

Sugjerohet se placenta çliron disa substanca, të cilat shkaktojnë dëmtim të endoteliumit të enëve të gjakut te nëna. Tensioni i lartë i gjakut është simptoma kryesore dhe që kontribuon në dëmtimin e konsiderueshëm të veshkave, mëlçisë dhe sidomos endoteliumit të nënës (95).

Toksemia pre-eklamptike mund të ndodhë në 20 javë të shtatzënisë; por duhet theksuar se kursi i sëmundjes është i ndryshëm në pacientë të ndryshëm. Shumica e rasteve diagnostikohen para kohe. Kur ai ndodh para 32 javëve, mendohet se është i shoqëruar me shkallë të lartë vdekshmërie. Largimi i placentës është trajtimi i fundit që mund të jetë për të nxitur lindjen, abortin apo operacionin Cesarian. Ajo gjithashtu mund të ndodhë deri në gjashtë javë mbas lindjes. Në mesin e komplikimeve serioze të shtatzënisë pre-eklampsia është më frekuente; ajo mund të ndikojë si te nëna ashtu edhe të mbijetesa e fetusit.

Eklampsia

Kjo fjalë rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë "e beftë", një fjalë e përdorur nga Hipokrati për të përmendur një ethe me zhvillim të shpejtë (96). Eklampsia është një komplikacion i rrezikshëm i shtatzënisë me një fillim të papritur dhe ka tiparet e zhvillimit me kriza tonike-klonike tek një pacient që ka zhvilluar preeklampsinë. Eklampsia pa fillimin paraprakisht të pre-eklampsisë është e rrallë. Pre-eklampsia dhe eklampsi së bashku quhen çrregullime hipertensive ose toksemi e shtatzënisë (97).

Hipertensioni gravidar

Hipertensioni pa proteinuri, qe shfaqet mbas javës së 20 të barrës quhet HTA gravidar. Ai diagnostikohet vetëm gjatë barrës dhe mund te komplikohet edhe me preeklampsi ose të rishfaqet si HTA kronik, i cili prezantohet mbas javës së 20.

Tensioni arterial normalizohet mbas javës së 12 të gravidancës. Mund të përsëritet në gravidancat e ardhshme dhe është parashikues i HTA esencial në të ardhmen (98).

1.6. Fiziologjia patologjike e eklampsisë dhe preeklampsisë

Ekzistojnë një numër teorish për të shpjeguar eklampsinë dhe pre-eklampsinë, të cilat sugjerojnë që ato janë prezente deri në momentin që placenta është e pranishme. Situata përmirësohet menjëherë mbas largimit të saj. Është propozuar që hipoperfuzioni i placentës është faktori kryesor përgjegjës për ecurinë e sëmundjes (99). Enët maternale të gjakut janë më të ndjeshme ndaj agjentëve të presionit, të cilët shkaktojnë ngushtimin e tyre duke rezultuar me hipoperfuzion në organe të ndryshme. Për më tepër, kushtet do të përkeqësohen me aktivimin e vargut të koagulimit që shkakton formim mikrotombie. Zhvillimi i edemave me çlirim të plazmës në enët e jashtme vaskulare i përkeqëson më tepër kushtet. Këto ndryshime shkaktojnë shënjat dhe simptomat e eklampsisë si edhe hipertension, çrregullim renal, hepatik dhe pulmonar, por veçanërisht atë cerebral. Aktivimi endotelial dhe numri i ndryshuar i pllakëzave janë shënjat e ecurisë së sëmundjes para zhvillimit të shenjave dhe simptomave (100).

Eklampsia konsiderohet si një lloj i encefalopatisë hipertensive në induktimin e këtyre ndryshmeve patologjike, të cilat çojnë në pre-eklampsi. Është konstatuar se një zvogëlim i rezistencës vaskulare cerebrale shkaktn një rritje të fluksit të gjakut në tru. Në vazhdim, funksionimi jo-normal i endoteliumit, çon në edemë cerebrale. Në përgjithësi një konvulsion eklamptik nuk çon në dëmtim të përhershëm të trurit, por gjithsesi mund të ndodhë një hemorragji intrakraniale (101).

Shkaqet

Në shumicën e reasteve, shkaku i HISH është i lidhur me implementimin e cekët të placentës si rezultat i së cilës ajo bëhet hipoksike dhe shkakton reaksione imune. Ajo karakterizohet nga një çlirim i mesazherëve inflamatorë nga placenta që veprojnë në endoteliumin vaskular. Ky invasion jo i plotë supozohet të ndodhë nga përgjigja imunologjike e nënës ndaj placentës. Nga kjo teori, është e qartë që përgjigjet maternale imunologjike ndaj antigjenit paternal, i cili është i pranishëm në fetus, luajnë një rol kyç. Në pak raste të HISH duket që receptorëve maternalë u mungon proteina, të cilën e sektreton placenta me qëllim rregullimin e përgjigjes së sistemit imunitar në të.

Nëse pre-eklampsia nuk do të trajtohet në kohë, ajo çon në pre-eklampsi fulminante, me çrregullime të dukshme, dhembje koke dhe epigastrike. Shkëputja e

placentës dhe sindroma HELLP (Hemolisis Elevated Liver Enzymes Low Platelet) janë të lidhura gjithashtu me shtatzëninë me hipertension (102,103).

Për të qartësuar faktin pse fillon HISH janë propozuar risa hipoteza, të cilat e kanë lidhur sindromën me ekzistencën e faktorëve të mëposhtëm:

I. Dëmtim i qelizave endoteliale
II. Kundërshtim imun i placentës
III. Reaktivitet vaskulat i ndryshuar
IV. Perfusion placental i prekur
V. Zvogëlim i shpejtësisë glomerulare të filtrimit me mbajtje të kripës dhe ujit
VI. Zvogëlim i vëllimit intravaskular
VII. Çrregullim i ekuilibrit ndërmjet prostaciklinës dhe tromboksanit
VIII. Faktorë gjenetikë
IX. Faktorë dietikë, përfshirë deficiencën në vitamina

Zhvillimi i sindromës ndodh në dy stade, me një stad të parë shumë të ndryshueshëm, i cili influencon placentën të kalojë në gjendje hipoksike, pra me nivel të ulët të oksigjenit në këtë organ, dhe u ndjekur nga shkarkimi i faktorit të tretshmërisë, i cili prek disa prej fenomeneve të vrojtuar (104).

1.7. Epidemiologjia e hipertensionit të induktuar gjatë shtatzënisë

Prevalenca e shtatzënisë nxit hipertensionin në 10% të shtatzënive, kryesisht në dy trimestrat e fundit dhe mbas javës së 32 të konceptimit. Në raste të rralla është e pranishme që në 20 javët e para. Nënat primiparus janë më të prekura dhe me zvogëlim të mundësisë për përsëritje të sëmundjes në shtatzënitë e tjera (105).

Hipertensioni i induktuar nga shtatzënia është i zakonshëm në gratë të cilat kanë histori të presionit të gjakut, sëmundje autoimune si diabet, sëmundje renale, lupus, trombofili të trashëguar si Faktori V Leiden; ose gratë me histori familjare të HISH, në gratë më shtatzënitë e shumëfishta (binjak, trinjak, dhe më tepër) dhe në gratë obeze.

2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

2.1. Qëllimi i Studimit

Qëllimi i këtij studimi ishte i trefishtë, përkatësisht:

I. Përcaktimi dhe krahasimi i nivelit të lipideve në serum tek gratë shtatzëna me hipertension të induktuar gravidar dhe gratë që kanë me shtatzëni normale pa hipertension të induktuar në Shqipëri.

II. Vlerësimi i lidhjes / shoqërimit midis fraksioneve të ndryshme të lipideve në serum dhe nëntipeve të hipertensionit të induktuar gravidar.

III. Vlerësimi i lidhjes/shoqërimit të hipertensionit gravidar me moshën, indeksin e masës trupore dhe shtatzëninë tek gratë e grupeve të ndryshme.

2.2. Objektivat Specifike të Studimit

- Vlerësimi i lidhjes/shoqërimit të nivelit të lipideve në serum sipas pranisë së hipertensionit të induktuar tek gratë shtatzëna.
- Vlerësimi i lidhjes/shoqërimit sipas nivelit të lipoproteinave me densitet shumë të ulët (VLDL) në serum në funksion të pranisë së hipertensionit të induktuar.
- Vlerësimi i lidhjes/shoqërimit sipas nivelit të lipoproteinave me densitet të ulët në serum (LDL) në serum në funksion të pranisë së hipertensionit të induktuar.
- Vlerësimi i lidhjes/shoqërimit sipas nivelit të lipoproteinave me densitet të lartë (HDL) në serum në funksion të pranisë së hipertensionit të induktuar.
- Vlerësimi i lidhjes/shoqërimit sipas nivelit të triglicerideve në serum në funksion të pranisë të hipertensionit të induktuar tek gratë shtatzëna.

- Vlerësimi i lidhjes/shoqërimit të hipertensionit gravidar në funksion me moshën e grave.

- Vlerësimi i lidhjes/shoqërimit të hipertensionit gravidar në funksion me treguesin e masës trupore të grave.

2.3. Hipotezat e Studimit

- Ka një tendencë rritëse të prevalencës së hipertensionit arterial të induktuar në gratë shtatzëna si rezultat i rritjes së nivelit të lipideve në serum.
- Ekziston një lidhje (shoqërim) pozitive ndërmjet hipertensionit arterial të induktuar gjatë shtatzënisë dhe moshës së grave.
- Ekziston një lidhje (shoqërim) pozitive ndërmjet hipertensionit arterial të induktuar gjatë shtatzënisë dhe nivelit të lartë të lipoproteinave VLDL në serum.
- Ekziston një lidhje (shoqërim) pozitive ndërmjet hipertensionit arterial të induktuar gjatë shtatzënisë dhe nivelit të lartë të lipoproteinave LDL në serum.
- Ekziston një lidhje (shoqërim) pozitive ndërmjet hipertensionit arterial të induktuar gjatë shtatzënisë dhe nivelit të lartë të lipoproteinave HDL në serum.
- Ekziston një lidhje (shoqërim) pozitive ndërmjet hipertensionit arterial të induktuar gjatë shtatzënisë dhe nivelit të lartë të triglicerideve në serum.
- Ekziston një lidhje (shoqërim) pozitiv ndërmjet hipertensionit arterial të induktuar të shtatzënisë dhe treguesit të masës trupore të grave.

3. METODOLOGJIA

Një studim kros-seksional (transversal) analitik u realizua në qytetin e Tiranës, gjatë periudhës kohore 2013-2015 për përcaktimin e nivelit dhe determinantëve të hipertensionit arterial të induktuar tek gratë gjatë periudhës së shtatzënisë.

3.1. Popullata në studim

Popullata e marrë në studim përbëhej nga gra shtatzëna, në moshën gestacionale ≥20 javë, të prekura nga hipertensioni arterial i induktuar, me ose pa proteinuri dhe edema, me presion sistolik ≥140 mmHg dhe presion diastolik ≥90 mmHg me matje të përsëritura. Në studim u përfshinë 122 gra, nga të cilat 26 gra me hipertension arterial të induktuar gjatë shtatzënisë, 68 gra shtatzëna pa hipertension të induktuar gjatë shtatzënisë, dhe 28 janë gra jo shtatëzëna, pa hipertension.

3.2. Prelevimi i kampionaturës

Kampionet e gjakut venoz u morën nga dy grupet në studim: nga grupi me sëmundje dhe nga grupi i kontrollit.

Një vëllim prej 5 mL gjak u administrua me anë të metodës rutinë duke aplikuar teknika aseptike, dhe Tourniquet, për një kohë të shpejtë. Një vëllim 1ml gjak u transefura në një tub vacutainer EDTA. Kjo mostër u përdor për të matur hemoglobinën, vlerat absolute dhe numërimin e trombociteve. Sasia prej 4.0 ml gjak u transferua në një tub vacutainer pa koagulant. Të gjitha mostrat u transferuan me kontenierë me akull në laboratorin PMRC, pranë Qëndrës Spitalore Universitare. Mbas koagulimit të gjakut, secili kampion u centrifugua për një kohëzgjatje 10 minuta me rrotullim në 3000 rpm për të përftuar një serum të pastër, pa qeliza. Kampionet e përpunuara, u izoluan dhe identifikuan me etiketimin e duhur.

Analiza biokimike e lipoproteinave përfshiu kolesterolin total (TC), kolesterolin e lipoproteinave me densitet të lartë (HDL-C), kolesterolin e lipoproteinave me densitet të ulet (LDL-C), kolesteroli i lipoproteinave me denstet shumë të ulët (VLDL-C), Trigliceridet (TG), apolipoproteina A_1 (APO-A_1), apolipoproteina B100 (APO-B100), Lipoproteina-a (LPA) dhe parametrat hematologjikë të cilët përfshinin Hemoglobinën (Hb), numrin e trombociteve dhe vlerat absolute të tyre. Lipidet e serumit u analizuan me metodën enzimatike duke përdorur Aparaturën Microlab 200 Semi Auto Kimi Analizues (Merck).

Numërimi i plotë i rruazave të gjakut dhe vlerat absolute u matën duke përdorur autoanalizuesin hematologjik Humacount Plus. Pjesa tjetër e serumit nga secili subjekt në studim u konservua në tub plastik epindorph në frigorifer ngrirje (-

20^{o}C). Vlerat APO-A1, APO-B100 dhe LPA në serum u matën në laboratorët specifikë patologjikë të maternitetit.

Trigliceridet dhe kolesteroli total në serum u matën duke përdorur Metodën enzimatike të mjeteve diagnostike Elitech, ndërsa HDL-C në serum u mat duke përdorur mjetet diagnostike Merck. Për sa i përket vlerave të LDL-C në serum ato u llogaritën nga formula Frederickson- Friedwald sipas të cilës:

LDL-C = TC – kolesterol HDL - kolesterol VLDL

Vlera e VLDL-C u llogarit si 1/5 e vlerave të trigliceridеve.

Gjatësia

Një parametër i përfshirë në diskutimin e rezultave ishte edhe gjatësia e subjekteve, e cila u përcaktua në pozicion vertikal.

Pesha trupore

Pesha trupore e subjekteve u mat me anë të një peshoreje të saktë fizike, në pozicion vertikal, dhe me veshje minimale. Saktësia e matjeve u testua paraprakisht nëpërmjet kalibrimit të peshores.

Indeksi i Masës Trupore /Body Mass Index (BMI)

Kjo vlerë u përllogarit duke përdorur formulën në lidhje me vlerën e masës (peshës) dhe gjatësisë së individit:

$$BMI = \text{Pesha (kg)} / (\text{Lartësia})^2 \text{ (m)}$$

Regjistrimi i Presionit të gjakut

Të dy presionet, ai sistolik dhe diastolik të gjakut u matën me një sfingomanometer me merkur standart në krahun e djathtë. Subjektet ishin në pozicion ulur ose të mbështetur dhe regjistrimet u morën pas një periudhe prej 5 minuta pushimi në pozicionin e regjistrimit. Regjistrimet u kryen në intervale kohore 5 minuta secili, dhe u morën vlerat e tyre mesatare. Shkalla e hipertensionit u përcaktua direkt nga presioni i gjakut të matur. Gratë e konstatuara me hipertension, më tej iu nënshtruan analizave për praninë e proteinave në urinë, duke përdorur metodën dipstick.

Hipertensioni

Presioni Normal i gjakut (BP)	Sistolik <120 mmHg
	Diastolik <80 mmHg
Prehipertension	Sistolik 120-139 mmHg
Normal - normal i lartë (presion i gjakut)	Diastolik 80-89 mmHg
Hipertensioni i butë	Sistolik 140-159 mmHg
(Faza-1)	Diastolik 90-99 mmHg
Hipertension i moderuar	Sistolik > 160 mmHg dhe / ose
Hipertensioni i rëndë	Diastolik > 100 mmHg
(Faza-2)	

Mbipesha dhe Obeziteti

BMI < 18.5 kg / m^2	Nënpesha
BMI ≥ 18.5 kg / m^2 në < 23.0 kg / m^2	Normal
BMI ≥ 23.0 kg / m^2	Mbipesha
BMI ≥ 25.0 kg / m^2	I trashë
BMI ≥ 27.0 kg / m^2	Shumë i trashë

Anemia

Hb ≥ 12.0 g%	Normal
Hb 10,5-11,9 g%	Anemi mesatare
Hb 10,4-7,7 g%	Anemi e moderuar
Hb < 7.7 g%	Anemi e rëndë

Numërimi i trombociteve

≥ 150 (mijë / μL)	Normal
100-150 (mijë / μL)	I ulët (trombocitopeni)
<100 (mijë / μL)	Shumë i ulët (trombocitopeni e rëndë)

Përcaktimi i kolesterolit total (TC) në serum

Për përcaktimin e kolesterolit total u përdorën reagentët PAP. Metoda kolorimetrike enzimatike u përdorën kitet diagnostike Elitech.

Teknika kryesore

Për të përcaktuar kolesterolin total dhe acidet yndyrore nëpërmjet veprimit të kolesterol esterazës, kolesteroli i lirë në mostër oksidohet në 4-Cholesten-3-on dhe formohet peroksid hidrogjeni. Sasia e peroksidit të hidrogjenit të formuar është në proporcion me nivelin e kolesterolit në gjak. Peroksidi i hidrogjenit reagon me 4-aminoantipirinën dhe fenolin në prani të peroksidazës dhe prodhon një përbërje kininike me ngjyrë të kuqe, i cili matet në gjatësinë e valës 500 nm duke përdorur një Analizues Kimik Semi Automatik (Microlab 200 Merck).

Në vijim është përbërja e kitit të Kolesterolit Total PAP, Metoda Kolorimetrike enzimatike e Elitech.

Reagenti 1

Tuba buffer, pH 6.90	50 mmol / L
Klorat natriumi	0.5 mmol / L
Fenol	24 mmol / L

Reagenti 2

Kolesterol esteraza	≥ 200 U / L
Peroxidaza	≥ 1000 U / L
Kolesterol oxidaza	≥ 250 U / L

4-Aminoantipirina	0.5 mmol / L

Standard

Kolesteroli	200 mg / dL

Vlerat e referimit

Serum, plazma	150-206 mg / dL

Mostrat

Serum, Heparin plazma

Procedura

Reagentët e punës u përgatitën duke tretur reagentin 2 në reagentin 1, i cili është i qëndrueshem për një afat kohor tre muaj në 2-8 ^{o}C dhe për 3 javë në 20-25 ^{o}C.

Tre tuba të vegjël u etiketuan si: standard, i bardhë (blank) dhe mostër. Një vëllim 1 ml regent pune u shtua në secilin tub. Në secilin prej tubave: standard, i bardhë dhe të mostrës 10 µL, u shtua përkatësisht solucion standard, ujë i distiluar dhe mostër. Reagentet u përzienë dhe mbas 5 minuta inkubacion u mat densiteti optik (OD). Ngjyra finale rezultoi e qëndrueshme për një orë.

Llogaritje

Ekuacioni i mëposhtëm u përdor për llogaritjen e kolesterolit.

$$\frac{OD_{Sample}}{OD_{Standard}} \times n$$

Ku n = përqendrimi standart (200 mg / dL)
Për këtë kit, lineariteti i kurbës varionte deri në përqendrimin 500 mg / dl.

Përcaktimi i kolesterolit të lipoproteinës me Dendësi të lartë (HDL-C)

Parimi:

Serumi u centrifugua me klorur magneziumi dhe acidit fosforik volfranik, në mënyrë që apoproteina-B të precipiton (LDL-C dhe VLDL-C). Supernatanti i përftuar në këtë menyrë përmban apoproteina-a (kolesteroli HDL). HDL-C reagon me reagentin e kolesterolit dhe oksidohet në kolestenon dhe peroksid hidrogjeni nëpërmjet veprimit të kolesterol oksidazës. Peroksidi i hidrogjenit i prodhuar në këtë mënyrë është drejtpërdrejt në proporcion me sasinë e HDL-C në serum. Peroksid hidrogjeni, mbas reaksionit me 4-aminoantipirinën, jep 4-*p*-(benzokinon-monoimino)-fenazon, i cili është kompleks me ngjyrë të kuqe. Absorbanca e tij matet në gjatësinë 546 nm, duke përdorur Microlab 200 Merck.

Procedura:

Një vëllim 0.2 ml serum dhe 0.5 ml reagent u pipetuan në një tub dhe u inkubuan për 10 minuta në temperaturën e dhomës. Më pas përmbajtja u centrifugua për 15 minuta me shpejtësi 5000 rpm. Më pas vëllimi 0.1 ml supernatant u mor dhe u përzie me 1 ml

reagent kolesteroli dhe u inkubua për 15 minuta në temperaturën e dhomës. Absorbanca u mat në gjatësinë 546 nm.

Përcaktimi i trigliceride ve (TG)

Reagentët e përdorur në testin enzimatik kolorimetrik, i lëngshëm, të triglicerideve, metodat PP-PAP u përftuan nga kitet e Elitech diagnostics, (Francë).

Parimi:

Niveli i triglicerideve në gjak përcaktohet me metodën enzimatike me anë hidrolizës së triglicerideve në glicerinë dhe acide yndyrore duke përdorur lipoproteinë lipazat. Glicerina më tej fosforilohet në glicerinë-3 fosfat duke përdorur glicerinë kinazën në praninë e ATP-së. Glicerol-3 fosfati në vijim nën veprimin e glicerinë-3 fosfat oksidazës do të oksidohet, me prodhimin e menjëhershëm të peroksidit të hidrogjenit. Më tej peroksidi i hidrogjenit reagon me 4-aminoantipirinën dhe prodhon një përbërje të kuqe kinine nën veprimin e peroksidazës. Absorbanca e kininës matet pastaj në 546 nm duke përdorur Microlab 200 Merck.

Reagentët: Reagenti 1 përbëhet nga 4-aminoantipirina 0.7 mmol/L, ATP 0.3 mmol/L dhe enzima lipoprotein lipazë > 1100 U/L, glicerol kinaza > 800 U / L, glicerol -3-fosfat oksidaza > 3000 U / L dhe peroksidaza > 350 U / L.

Reagent 2 përbëhet nga tretësirë tampon me pH 7.50, me përqendrim 50 mmol / L.

Standardi:
Përbëhej nga trigliceride, 2.28 mmol / l ose 200 mg / dl ose 2,0 g / l
Përgatitja e reagentit të punës:
Reagenti i punës përgatitet duke tretur reagentin 2 në reagentin 1 dhe ruhet në frigorifer.

Procedura:

Një vëllim prej 10 uL ujë të distiluar, standard dhe mostër, kalohen respektivisht në tre kuveta të veçanta: e bardhë, standarde dhe mostër. Vëllimi 1 mL nga reagenti i punës u shtua në çdo kuvetë. Tretësira u përzie dhe u inkubua për 5 minuta në 37^{o}C. Absorbanca e tretësirës u mat në gjatësinë 546 nm në Microlab 200 referuar ‘mostrës së bardhë’.

Llogaritja e rezultateve:

$$\text{Përqendrimi i mostrës (mg/dL)} = \frac{(\text{Absorbancë e mostrës} \times \text{Përqendrimi i Standard})}{\text{Absorbancë e Standardit}}$$

Përcaktimi i kolesterolit të lipoproteinës me densitet të ulët (LDL-C)

Parimi:

Një përcaktim i drejtpërdrejtë i LDL-C është i vështirë të realizohet për shkak të problemeve teknike. LDL-C u përcaktua nga formula e mëposhtme:

$$\text{Kolesterolit LDL (mg / dl)} = \text{TC} - \text{HDL} - \text{kolesterol} - \text{TG} / 5$$

Përcaktimi i kolesterolit të lipoproteinës me dendësi shumë të ulët (VLDL-C)

Parimi:

Nivelet VLDL-C përcaktohen nëpërmjet derivimit nga formula e mëposhtme:

$$Kolesterol\, VLDL - C\ (mg\ /\ dl) = Trigliceride\ /\ 5.$$

Përcaktimi i apolipoprotein-A1 (APO-A1)

Parimi Test

Mostra shtohet në reagentin-1 (tampon) dhe pas shtimit të reagent-2 (antiapolipoprotein A-1 antitrupa) realizohet analiza Imunoturbidimetrike. Antitrupat e Antiapolipoprotein A-1 reagojnë me antigjenin i pranishëm në mostër për të formuar kompleksin antigjen / antitrup, i cili në vijim aglutinohet dhe mund të matet me metodë turbidimetrike.

Reagentët- tretësirat e punës

R1- TRIS tampon: 50 mmol / L, pH8.0 PEG: 3.8% detergent; konservant (Gati për përdorim)

R2- Antitrupat Anti-human apolipoprotein A-1 (dele): varen nga titrimi;

TRIS buffer: 100 mmol / L, pH 8.0; konservant. (Gati për përdorim)

TRIS = Tris (hidroksimetil) aminometan

1) Kalibrues: C.f.a.s. (Kalibrues në sisteme të automatizuara) Lipide

2) Kontrolle: Precinorm L, L Precipath

3) Tretësirë normale e kripur 0.9% NaCl.

Kalibrimi

Gjurmueshmëria: Kjo metodë është standardizuar referuar standard referues IFCC SPI -01 (WHO-IRP tetor 1992)

Analizues Roche modular-P

S1: 0.9% NaCl

S2-S6: Lipide të holluara C.f.a.s.

Vlerat e lipideve specifike C.f.a.s. u shumëzuan me faktorët e dhënë më poshtë për të përcaktuar përqendrimet standarde për kurbën e kalibrimit në gjatë përqendrime.

S2. 0,206

S3: 0,404

S4: 1.000
S5: 1.312
S6: 2.000

Kontrolli i cilësisë
Për kontrollin e cilësinë u përdorën Precinorm L dhe Precipath L. Vlerat e përftuara me këto kontrolle rezultuan brenda vlerave mesatare (mesatare) limiteve/intervaleve të poshtëm dhe të sipërm.

Llogaritja
Analizuesi në mënyrë automatike llogarit përqendrimin analitik në çdo mostër.
Faktorët e konvertimit: mg / dL x 0,357 = umol / L
mg / dL x = 0,01 g / L
g / L x100 = mg / dL

Intervali i matjeve
Intervali i matjeve: 7.14-143 umol / L (0.20 -4.4.00g / L)

Vlerat e pritshme
Vlerat e mëposhtme janë marrë duke përdorur serum nga gra të shëndetshme:
38.6-80.3 umol / L (108-225 mg / dl: 1.08-2.25 g / L)

Përcaktimi i apolipoprotein-B 100

Analiza imunoturbidimetrike për përcaktimin sasior të apolipoproteinës A-1 në serum është bërë duke përdorur kits diagnostike Roche në Analizuesin klinik Roche Modular P-800, Cobas, Japoni.

Parimi i Testit

Analiza imunoturbidimetrike

Mostra shtohet në R1 (tampon), dhe R2 (anti-apolipoprotein B antitrupa). Antitrupat Antiapolipoprotein B reagojnë me antigjenin e pranishëm në mostër duke formuar kompleksin antigen / antitrup, i cili ndiqen nga aglutinimi. Në përfundim matja realizohet me mënyrën turbidimetrike.

Reagentët - tretësira e punës
R1 TRIS buffer: 50 mmol / L, pH 8.0; PEG: 4.2%; detergent; konservant
R2 Antitrupat anti-humanë apolipoprotein B (dele): varen nga titrim; TRIS buffer: 100 mmol / L, pH 8.0; konservant.
Ku [a] = Tris = Tris (hidroksimetil) aminometan
Reagent R1 dhe R2 janë gati për përdorim

Kalibrues: C.f.a.s. (Kalibrator për sistemet e automatizuar) Lipidet
Kontroll: Precinorm L, L Precipath
Serum ose Plasma: Li-heparin, Na-heparin, NH_4^+-heparin ose Na_2- EDTA plazma, K_2- EDTA plazma, K_3 EDTA-plazma.

Kalibrimi:
Analizues Roche MODULAR
S1: 0.9% NaCl
S2-S6: C.f.a.s. Lipide u përdorën si kalibrues.
Vlerat e lipideve C.f.a.s. specifike u shumëzuan me faktorët e dhënë më poshtë për të përcaktuar përqendrimet standarde për kurbën 6-pikëshe të kalibrimit.
S2: 0,318
S3: 0,600
S4: 1,615
S5: 2.100
S6: 3.500

Kontrolli i cilësisë
Për cilësinë e kontrollit është perdorur Precinorm L dhe Precipath L kontrolli. Vlerat qe u moren nga këto kontrolle ishin brenda vlerave mesatare (mjetet) vlerave/intervaleve të poshtme dhe të sipërme.

Llogaritja
Analizuesi llogarit automatikisht përqendrimin në analit të çdo mostre.
Faktorët e konvertimit: mg / dL x 0.0195b = μmol / L
mg / dL x = 0,01 g / L
g / L = x 100 mg / dL

Intervali i matjes
Analizues Roche MODULAR
Intervali i matjes: 0,39-7,8 μmol / L (20-400 mg / dl; 0,20-4,00 g / L)

Vlerat e pritshme
Vlerat e mëposhtme janë marrë duke përdorur serum nga të rriturit e shëndetshëm:
Burra (n = 150): 1,29-2,59 μmol / L (66-133 mg / dL; 0,66-1,33 g / L)
Gra (n = 150): 1,17-2,28 μmol / L (60-117 mg / dl; 0,60-1,17 g / L)

Lipoproteina (a)

Sistemi Informativ

Metoda imunoturbidimetrike për përcaktimin sasior të lipoproteinë (a) në serum është bërë duke përdorur kite Roche Diagnostic në Analyzuesin Kimik Klinik Roche Automated MODULAR P-800, Cobas, Japoni.

Test Principal

Metoda imunoturbidimetrike

Mostra shtohet në R1 (tampon) dhe R2 (antitrup anti-lipoprotein (a)) për të filluar reaksioni. Antitrupat anti-lipoprotein (a) reagon me antigjenin në mostër për të formuar një kompleks antitrup/antigen, i cili përcaktohet me turbidimetri pas aglutinimit.

Reagentët-tretësirat e punës

R1- Tampon Fosfat; 60 mmol / L, pH 7.5; NaCl 100 mmol / L
R2- Antitrupa lipoprotein anti-human (a) (lepur) i varur nga titri; NaCl: 100 mmol/L; stabilizator; konservant
Lipoprotein (a) humane
Kontrolli: Lp (a) Set Kontrolli
R1 dhe R2 janë gati për përdorim

Mostra

Serum
Na -Plasma: Li-heparin ose EDTA plazma.

Kalibrimi

Gjurmueshmëria: kjo teknikë është standardizuar ndaj një përgatitje tepër të pastër Lp(a), i cili përdoret një kalibrues (in house)
S1 0.9% NaCl
S2-6: kalibrator
Vlerat e kalibruesit të lipoproteinës (a) specifike shumëzohen me faktorët e mëposhtëm për të përcaktuar përqendrimet standarde për kurbën e kalibrimit gjashtë-pikëshe.
S2: 0.052
S3: 0.104
S4: 0,208
S5: 0.500
S6: 1.000

Kontrolli i cilësisë

Për kontrollin e cilësisë u përdorur një grup kontrolli LP (a).

Llogaritja

Analizuesi llogarit automatikisht përqendrimin e analitit të çdo mostre.
Faktorët e konvertimit: mg / dL x 0.01 = g / L
g / Lx 100 = mg / dL
Intervali i matjes
Roche / Hitachi 904/912/917 / MODULAR P analizues
Intervali i matjes: 6-160 mg / dL (0,06-1,60 g / L)

Intervali i zgjeruar i matjeve me përsëritjen automatike: 3-320 mg / dL (0,03-3,20 g / L)
Ndjeshmëria analitike (limit i poshtëm i detektimit)
Kufiri i detektimit: 6 mg / dl (0.06g / L)
Kufiri i detektimit përfaqëson nivelin më të ulët të detektueshëm analitik që mund të dallohen nga vlera zero. Ajo llogaritet si vlera që ndodhet tre shmangie standarde mbi atë të standardit të poshtëm (standard 1+ 3 SD, brenda saktësisë së metodës, n = 21).

Numërimi i plotë i elementëve prezentë në gjak

Numërimi i plotë i elementëve prezentë në gjak dhe vlerat absolute tek gratë e përfshira në studim u matën duke përdorur tre teknikat dimensionale;

Analyzer Humacount Plus.

Zgjidhje reagent dhe konsumi

Përmbajtja HC-hollues

1. (DIL} Diluents (hollues), përdoret për të holluar gjakun komplet të mostrave dhe për shpëlarjen e sistemit fluidik pas çdo matje.

Buffer <0,05%, pH 6.9+ 0.2

Sulfat natriumi <1.20%

Stabilizues <0.30%

Pastrues <0.01%

2. (LYSE}: **HC-Lyse CF**

Cyanide lyses pa reagent është përdorur për të përgatitur hemolizatin e gjakut për matjen e qelizave të bardha (WBC) dhe hemoglobina (Hb), e cila përbëhet si vijon.

i.	Klorur natriumi	<0.15%, pH 7.4 + 0.5
ii.	Acid organik	<0.25%
iii.	Kripërat amoniumit	<7.30%
iv.	Konservantë	<0.01%

3. {CLEAN}: **HC-Cleaner**

Tretësira pastruese është përdorur për të kryer procesin e pastrimit të fluideve dhe është i përbërë nga.

i.	Klorur natriumi	<0.10%, pH 8.0 + 0.2
ii.	Klorium kaliumi	<0.03%
iii.	Enzimat proteolitike	<0.02%
iv.	Stabilizues	<0.30%
v.	Detergent	< 0.40%

3.3. Analiza statistikore

Të dhënat u përpunuan me anë të paketës statistikore SPSS (Special Program for Social Sciences) versioni 17. Të dhënat numerike dhe kategorike u prezantuan si vlera mesatare. Testi i Studentit u përdor për të vlerësuar dallimet në përqendrimet mesatare të lipideve në serum ndërmjet pacientëve dhe subjekteve të kontrollit. Rëndësia ndërmjet vlerave mesatare të grupeve u shprehën nëpërmjet vlerave të termit 'P'. Intervali i Besueshmërisë 95% (CI) P <0.05 u konsiderua si i rëndësishëm. Për të përcaktuar lidhjen relative midis hipertensionit të shkaktuar nga shtatzënia dhe përqendrimeve të ndryshme të lipideve dhe lipoproteinave u përdor metoda e regresit logjistik. Ndërsa llogaritja e vlerave maksimale të probabilitetit për koeficientët dhe gabimet e tyre standarde u krye duke llogaritur raportin e rastësishëm (OR) dhe intervalin e besueshmërisë 95% (CI).

Pacientët u klasifikuan sipas dy kategorive: HISH i butë dhe i rëndë, duke marrë vlerat ≥ 110 mmHg për BP diastolik dhe ≥ 150 mmHg për BP sistolik si nivele diferencimi. Koeficienti i korrelacionit 'r' u përcaktua edhe për indekse të ndryshme biokimike duke përdorur korrelacionin *Produkt Pearson-Moment* në paketën statistikore SPSS 17.

4. REZULTATE

Në studim u përfshinë 122 subjekte të cilët u ndanë në tre grupe (Tabela 5). Në grupin e parë u përfshinë 26 gra shtatzëna të sëmura me hipertension të induktuar në shtatzëni (HISH); në grupin e dytë u përfshinë 68 gra shtatzëna pa HISH; dhe në grupin e tretë 28 gra jo-shtatzëna dhe pa HISH.

Mosha mesatare ishte lehtësisht më e lartë tek subjektet e grupit të parë krahasuar me dy grupet tjera (përkatësisht: 30.3, 29.5 dhe 30.01 vjeç). Gjithashtu edhe në rastin e moshës martesore u evidentua që subjektet e grupit të parë kishin moshë më të madhe krahasuar me dy grupet tjera (përkatësisht: 21.7 kundrejt 20.7 dhe 18.9 vjeç) (Tabela 5).

Nga të dhënat e tabelës 5 konstatohet që numri më i madh i lindjeve ishte tek subjektet e grupit të grave shtatzëna me HISH, ashtu si edhe numri i lindjeve të gjalla. Nga ana tjetër numri më i lartë i feto-morto rezultoi përsëri në subjektet e grupit të parë krahasuar me grupet e tjera (përkatësisht 0.27 kundrejt 0.23 dhe 0.15 për 1000 lindje). Përsa i përket numrit të aborteve u vu re që femrat e grupit të tretë e kishin lehtësisht me të lartë se grupet tjera (0.35 kundrejt 0.34 tek grupi pare dhe 0.31 tek grupi dytë).

Gjithashtu u raportua që numri i lindjeve me seksio cezarea rezultonte më i madh tek subjektet e grupit të dytë duke i krahasuar me dy grupet e tjera (0.46 kundrejt 0.42 te grupi parë dhe 0.37 tek grupi tretë).

Bazuar në presionin sistolik të subjekteve të përfshirë në studim u evidentua që gratë e grupit të parë e kishin shumë më të lartë (151.49 mmHg), krahasuar me dy grupet tjera (përkatësisht 137.2 dhe 116 mmHg), ashtu si edhe në rastin e presionit diastolik. U konstatua që gjatësia e subjekteve ishte pak më e lartë në grupin e dytë krahasuar me dy grupet e tjera, ndërkohë që gratë e grupit të parë kishin peshë pak më të madhe kundrejt dy grupeve të tjera dhe rrjedhimisht edhe treguesi i masës trupore ishte pak më i lartë tek subjektet e grupit të parë (28.2) krahasuar me dy grupet e tjera, përkatësisht 27.8 dhe 26.9.

Niveli i hemoglobinës dhe i plateleve rezultoi i shpërndarë pothuajse në mënyrë të njëjtë midis tre grupeve të studimit.

Vihet re që mosha e subjekteve që vuajnë nga HISH është në mënyrë sinjifikante më e lartë krahasuar me moshën e subjekteve që nuk kanë HISH ($p=0.039$). Edhe në rastin e moshës martesore vihet re lidhje shumë sinjifikante statistikore me praninë e HISH tek subjektet e përfshira në studim ($p=0.001$).

Tabela 5. Karakteristikat socio-demografike dhe riprodhuese të subjekteve të përfshirë në studim

Variabli	Gra shtatzëna me HISH Nr = 26	Gra shtatzëna pa HISH Nr=68	Gra jo-shtatzëna, pa HISH Nr=28
Mosha	30.3±0.66*	29.54±0.68	30.01±0.66
Mosha martesore	21.74±0.59	20.76±0.57	18.9±0.53
Java e shtëtzënisë	30.01±0.49	31.39±0.48	29.72±0.55
Numri lindjeve	3.08±0.53	3.01±0.59	2.88±0.27
Lindje të gjalla	2.93±0.26	2.36±0.27	2.58±0.25
Lindje fetusi të vdekur	0.27±0.13	0.23±0.11	0.15±0.06
Nr. Aborteve	0.34±0.08	0.31±0.07	0.35±0.007
Nr.seksio-cesarea	0.42±0.04	0.46±0.06	0.37±0.56
Presioni sistolik mmHG	151.49±1.25	137.21±1.79	116±0.91
Presioni diastolik mmHg	99.91±0.84	91.45±1.34	75.28±0.91
Gjatësia	162±0,91	164.10±0.87	159.53±1.22
Pesha	60.86±1.35	58.35±0,54	56.21±1,11
TMT (kg/m^2)	28.25±0.78	27.89±1,32	26.98±0.87
Platelet (1000/µL)	233.24±7.64	227.50±9.35	241.44±8.28
Hb (g/dL)	10.29±0.20	9.99±0.20	10.19±018

*Vlerat mesatare dhe shmangia standarde

Nga ana tjetër në rastin e numrit të lindjeve të gjalla, fetomorto, aborteve dhe seksio cezarea nuk u raportua lidhje sinjifikante statistikore me hipertensionin e induktuar të shtatzënisë.

U evidentua që presioni sistolik dhe presioni diastolik shfaqën lidhje shumë të fortë sinjifikante statistikore me praninë e sëmundjes në grupin e subjekteve të përfshirë në studim ($p<0.001$).

Pesha e subjekteve të përfshirë në studim shfaqi sinjifikancë statistikore në kufinjtë e saj ($p=0.050$) më sëmundjen HISH, rezultat që nuk u raportua në rastin e

analizimit të gjatësisë së subjekteve dhe të treguesit të masës trupore dhe të nivelit të hemoglobinës.

Tabela 6. Krahasimi i karakteristikave socio-demografike dhe riproduktive të subjekteve me HISH dhe subjekteve pa HISH

Variabli	Gra shtatzëna me HISH Nr = 26	Gra (shtatzëna +jo-shtatzëna) pa HISH Nr=96	Vlera e P[£]
Mosha	30.04±0.38*	28.18±0.66	0.039
Mosha martesore	20.95±0.31	18.9±0.53	0.001
Java shtëzanisë	31.09±0.27	29.72±0.55	0.050
Numri lindjeve	3.12±0.29	3.01±0.12	0.123
Lindje të gjalla	2.15±0.14	2.58±0.25	0.201
Lindje fetusi i vdekur	0.21±0.14	0.15±0.06	0.07
Nr. Aborteve	0.37±0.04	0.39±0.09	0.097
Nr.seksio-cesarea	0.37±0.03	0.39±0.07	0.152
Presioni sistolik mmHG	150.38±0.67	116±0.91	<0.001
Presioni diastolik mmHg	99.88±0.75	75.28±0.87	<0.001
Gjatësia	161.36±0,79	159.53±1.22	0,149
Pesha	61.27±0.74	57.12±0,78	0.05
TMT (kg/m^2)	27.75±0.98	26.13±1,12	0.102
Platelet (1000/µL)	215.85±5.14	261.44±8.27	0.001
Hb (g/dL)	10.16±0.11	10.19±0.18	0.087

*Vlerat mesatare dhe shmangia standarde

[£]Vlera e sinjifikancës statistikore P sipas testit T të Studentit

Tabela 7 dhe figura 1 paraqesin shpërndarjen e subjekteve të sëmura me HISH, në studim dhe subjekteve që nuk vuajnë me HISH sipas grup-moshës. Midis grave të cilat janë të prekura nga HISH pjesa më e madhe e tyre i përkiste grup-moshës 26-30 vjeç (26.4%), ashtu si edhe në rastin e subjekteve të cilat nuk kishin HISH (28.0 %).

Tabela 7. Shpërndarja e grup-moshës së subjekteve të studimit sipas pranisë së hipertensionit të induktuar të shtatzënisë

Mosha	Me HISH		Pa HISH	
	N	%	N	%
≤20 vjeç	2	15.0	21	22.4
21-25 vjeç	7	24.0	26	27.6
26-30 vjeç	11	26.4	27	28.9
31-35 vjeç	3	17.3	13	12.2
>35 vjeç	3	17.3	9	8.9
Totali	26	100%	96	100%

Figura 1. Shpërndarja e grup-moshës së subjekteve të studimit sipas pranisë së hipertensionit të induktuar të shtatzënisë



Më poshtë në tabelën 8; figurat 2 dhe 3, paraqitet lidhja mes moshës martesore të subjekteve dhe hipertensionit të induktuar të shtatzënisë. U raportua që sipas moshës

referuese (21-25 vjeç), grup-moshat e tjera kishin probabilitet më të ulët për zhvillimin e hipertensionit të induktuar të shtatzënisë duke mos rezultuar në lidhje (shoqërim) statistikore sinjifikante.

Tabela 8. Lidhja ndërmjet moshës martesore të subjekteve me hipertensionin e induktuar të shtatzënisë

Mosha martesore	Me HISH		Pa HISH		Raporti i gjasave OR		
	N	%	N	%	OR(95%CI)	$\chi 2$	Velera P
16-20 vjeç	2	15.0	21	22.4	0.96(0.48-1.91)	10.36	0.298
21-25 vjeç	7	24.0	26	27.6	1.00 (Referencë)		
26-30 vjeç	11	26.4	27	28.9	0.44(0.12-1.52)	2.04	0.151
>30 vjeç	6	34.6	22	21.1	0.77(0.2-2.80)	0.18	0.661
Totali	26	100%	96	100%			

Figura 2. Shpërndarja e moshës martesore të subjekteve të studimit sipas pranisë së hipertensionit të induktuar të shtatzënisë



Figura 3. Lidhja ndërmjet moshës martesore të subjekteve me hipertensionin e induktuar të shtatzënisë



Në tabelën 9 dhe figurën 4 raportohet lidhja midis historisë së mëparshme për raste lindje fetusi të vdekur, aborti dhe lindjeve me seksio cezarea dhe HISH. Nga studimi rezultoi që nuk ka lidhje sinjifikante statistikore mes HISH dhe abortit, seksio cezarea dhe fetomorto.

Tabela 9. Lidhja mes historisë së mëparshme të lindjes për fetus të vdekur, abortit dhe seksio-cezarea të subjekteve me hipertensionin e induktuar të shtatzënisë

Variabli	Me HISH		Pa HISH		Raporti i gjasave OR		
	Po	Jo	Po	Jo	OR(95%CI)	$\chi 2$	Velera P
Lindje fetusi të vdekur	2	24	2	94	1.87(0.85-4.26)	2.76	0.091
Abort	7	19	4	92	0.62(0.36-1.06)	3.44	0.062
Seksio-cezarea	16	10	11	85	1.29(0.49-3.63)	0.01	0.539

Figura 4. Lidhja mes historisë së mëparshme të lindjes për fetus të vdekur, abortit dhe seksio-cezarea të subjekteve me hipertensionin e induktuar të shtatzënisë



Tabela 10 paraqet lidhjen e koncentrimit lipoproteinik tek subjektet e përfshirë në studim dhe pranisë së HISH. Raportohet që niveli i kolesterolit total ishte në mënyrë sinjifikante më i lartë tek gratë me HISH, krahasuar me subjektet e dy grupeve të tjera sidomos me grupin e tretë (p=0.041). Gjithashtu raportohet lidhje shumë sinjifikante statistikore mes nivelit të VLDL kolesterolit dhe triglicerideve dhe pranisë së HISH, ku niveli i këtij fraksioni lipidik ishte dukshëm më i lartë tek subjektet e prekura nga HISH. Nga ana tjetër një lidhje sinjifikante statistikore u raportua edhe në rastin e fraksioneve të yndyrnave APO-A1, APO-B100 dhe LPA me praninë e hipertensionit të induktuar të shtatzënisë (përkatësisht: p=0.001, p=0.039 dhe p=0.001).

Tabela 10. Lidhja ekoncentrimit lipoproteinik mes subjekteve normotensivë të me subjektet me hipertensionin e induktuar të shtatzënisë

Lipoproteinat	Gra shtatzëna me HISH Nr = 26	Vlera P	Gra shtatzëna pa HISH Nr=68	Vlera P	Gra jo-shtatzëna pa HISH Nr=28
Kolesterol total (mg/dl)	219.76±5.58*	0.245	212.88±5.67	0.041	202.23±4.7
HDL (mg/dl)	44.95±1.08	0.043	40.83±0.93	0.001	52.20 ±1.14
LDL (mg/dl)	111.30 ±5.26	0.199	110.54±4.79	0.328	107.42±4.70
VLDL (mg/dl)	52.04±1.99	0.001	66.93±2.85	0.001	42.22±1.46
Trigliceridet (mg/dl)	295.05±10.0	0.001	337.71±14.34	0.001	212.30±7.28
APO-A1 (mg/dl)	177.86±5.67	0.410	144.43±4.50	0.001	190.14±5.31
APO-B100 (mg/dl)	112.24±4.29	0.041	120.07±4.35	0.039	128.33±5.50
LPA (mg/dl)	63.72±2.96	0.572	81.62±5.61	0.001	58.31±4.95

Tabela e mëposhtme evidenton lidhjen mes hISH dhe raportit lipoproteinik të subjekteve në studim. Vihet re lidhje sinjifikante statistikore në të gjithë fraksionet yndyrorë të përfshira në studim në raport me njëra tjetrën dhe praninë e HISH.

Tabela 11. Lidhja eraportit lipoproteinik mes subjektve normotensivë të me subjektet me hipertensionin e induktuar të shtatzënisë

Raporti Lipoproteinave	Gra shtatzëna me HISH Nr = 26	Vlera P	Gra shtatzëna pa HISH Nr=68	Vlera P	Gra jo-shtatzëna pa HISH Nr=28
TC:HDL-C	4.72±0.15*	0.001	5.49±0.17	0.001	3.87±0.1
LDL-C:HDL-C	2.50±0.13	0.012	2.77±0,12	0.001	2.05±0.09
TG:HDL-C	6.06±0.29	0.001	8.70±0.45	0.001	4.35±0.19
HDL-C:VLDL-C	1.02±0.005	0.001	0.71±0.03	0.001	1.36±0.006
LDL:APO-B100	1.03±0.02	0.044	1.02±0.06	0.017	0.81±0.05
HDL:APO-A1	0.26±0.09	0.660	0.31±0.01	0.049	0.28±0.12

Tabela 12 paraqet lidhjen mes nivelit të lipideve në gjak me praninë e hipertensionit të induktuar të shtatzënisë. Nga të dhënat e tabelës evidentohet që ka lidhje sinjifikante statistikore me nivelin e VLDL, trigliceridеve HDL kolesterolit me praninë e HISH, ndërsa kjo lidhje dobesohet në rastin e kolesterolit total, LDL kolesterolit dhe APO-B100.

Tabela 12. Lidhja e lipideve në gjak mes subjekteve normotensivë dhe me subjektet me hipertensionin e induktuar të shtatzënisë

Lipoprotein (mg/dL)	Me HISH	Pa HISH	Ndryshimi (%)	Vlera P
Total Cholesterol	213.25 ± 3.14	188.23 ± 4.6	5.5	NS
HDL-Cholesterol (mg/dL)	43.45 ± 0.58	52.20 ± 1.14	16.8	0.001
LDL-Cholesterol (mg/dL)	111.15 ± 2.91	93.42 ± 4.07	3.5	NS
VLDL-Cholesterol (mg/dL)	58.74 ± 1.44	42.22 ± 1.46	39.1	0.001
Triglyceride (mg/dL)	294.25 ± 7.24	212.30 ± 7.28	38.6	0.001
APO-A1 (mg/dL)	160.45 ± 3.11	190.14 ± 5.31	18.5	0.001
APO-B100 (mg/dL)	119.64 ± 2.55	128.33 ± 5.50	7.3	NS
LPA (mg/dL)	74.03 ± 4.17	58.3 ± 4.94	26.9	0.05

Gjithashtu në tabelën në vijim (tabela 13), evidentohet lidhja mes raportit lipoproteinik dhe pranisë së hipertensionit të induktuar të shtatzënisë, ku përveç raportit HDL/APO-A1, i cili nuk shfaq lidhje sinjifikante statistikore, të gjithë raportet tjera lipoproteinike të analizuara raportuan lidhje të fortë sinjifikante statistikore.

Tabela 13. Lidhja e raportit lipoproteinik mes subjekteve normotensivë të me subjektet me hipertensionin e induktuar të shtatzënisë

Parametrat	Me HISH	Pa HISH	%	Vlera P
TC : HDL-C	5.12 ± 0.09	3.74 ± 0.11	32.29	0.001
LDL-C: HDL-C	2.66 ± 0.07	1.86 ± 0.09	29.76	0.001
TG : HDL-C	7.24 ± 0.22	4.35 ± 0.19	66.44	0.001
HDL-C : VLDL-C	0.87 ± 0.02	1.36 ± 0.06	38.23	0.001
LDL: APO-B100	0.98 ± 0.03	0.81 ± 0.05	20.98	0.01
HDL: APO-A1	0.28 ± 0.007	0.28 ± 0.01	-	NS

Në vijim, në tabelën 14 raportohet lidhja mes nivelit të lipoproteinave dhe presionit sistolik mbi 150 mmHg, ku vetëm në rastin e fraksioneve VLDL dhe të triglicerideve dhe të raporteve proteinike TG/HDL dhe HDL/VLDL u evidentua një lidhje shumë sinjifikante statistikore ($p<0,001$), ndërsa në të gjitha rastet tjera vihet re që kjo lidhje vjen duke u dobësuar gjithnjë e më shumë.

Tabela 14. Lidhja midis lipoproteinave të subjekteve me presionin sistolik <150 mmHg dhe ≥150 mmHg

Koncentrimi lipoproteinave	Presioni sistolik <150 mmHg Nr=17	Presioni sistolik ≥150 mmHg Nr=9	Vlera e P
Kolesterol total (mg/dl)	211±4.71*	216.13±4.36	0.178
HDL-kolesteroli (mg/dl)	44,71±0.85	42.35±0.78	0.223
LDL-kolesteroli (mg/dl)	111.71±4.44	111.0±3.79	0.296
VLDL-kolesteroli (mg/dl)	53.95±1.53	63.89±2.46	<0.001
Trigliceridet (mg/dl)	270.77±7.84	319.53±12.59	<0.001
TC: HDL-C (raport)	4.89±0.13	5.32±0.13	0.051
LDL-C: HDL-C (raport)	2.60±0.11	2.71±0.10	0.096
TG: HDL-C (raport)	6.45±0.24	8.04±0.38	<0.001
HDL-C: VLDL-C (raport)	0.95±0.04	0.79±0.03	<0.001
APO-A1 (mg/dl)	161.68±4.44	159.4±4.54	0.302
APO-B100 (mg/dl)	118.15±3.67	121.42±3.46	0,149
LPA (mg/dl)	71.10±5.86	77.06±5.98	0.254
LDL: APO-B100	1.01±0.05	0.94±0.04	0.122
HDL: APO-A1	0.29±0.01	0.27±0.08	0.421

Nga ana tjetër në tabelën 15 paraqitet lidhja e nivelit dhe e raportit të lipoproteinave me nivelin e presionit diastolik mbi 110 mmHg. Nga analizimi i të dhënave rezultoi që fraksionet HDL, VLDL dhe trigliceridet shfaqën lidhje të fortë statistiksht sinjifikante (p=0.001), ashtu si edhe në rastin e raportit lipoproteinik të fraksioneve TG/HDL,HDL/VLDL dhe LDL/APO-B100, ndërkohë që kjo lidhje zhduket në rastin e fraksionevedhe raporteve të tjera lipoproteinike.

Tabela 15. Lidhja midis lipoproteinave të subjekteve me presionin sistolik <110 mmHg dhe ≥110 mmHg

Parametri	Presioni sistolik <110 mmHg Nr=14	Presioni sistolik ≥110 mmHg Nr=12	Vlera e P
Kolesterol total (mg/dl)	214±3.72*****	211.98±4.36	0.211
HDL-kolesteroli (mg/dl)	44,51±0.68	40.39±1.02	0.001
LDL-kolesteroli (mg/dl)	114.0±3.46	102.32±5.78	0.134
VLDL-kolesteroli (mg/dl)	55.39±1.44	70.30±3.84	0.001
Trigliceridet (mg/dl)	277.66±7.28	351.54±12.59	0.001
TC: HDL-C (raport)	5.00±0.10	5.44±0.18	0.059
LDL-C: HDL-C (raport)	2.67±0.09	2.60±0.15	0.164
TG: HDL-C (raport)	6.63±0.23	9.19±0.54	0.001
HDL-C: VLDL-C (raport)	0.93±0.03	0.69±0.04	0.001
APO-A1 (mg/dl)	160.01±3.68	162.1±6.28	0.179
APO-B100 (mg/dl)	117.75±3.04	125.44±4.92	0,222
LPA (mg/dl)	72.77±4.88	78.07±8.13	0.452
LDL: APO-B100	1.02±0.04	0.86±0.06	0.049
HDL: APO-A1	0.29±0.09	0.26±0.01	0.231

Ndërkohë që më poshtë në tabelën 16 raportohen nivelet e përqendrimit të fraksioneve të lipoproteinave dhe raportet e tyre të analizuara tek gratë primipare lidhur me praninë e HISH. Nga të dhënat evidentohet që koesteroli total, LDL kolesteroli, VLDL kolesteroli, trigliceridet janë në mënyrë sistematike më të larta tek gratë primipare që vuajnë nga HISH krahasuar me dy grupet e tjera. E njëjta situatë raportohet edhe për raportin lipoproteinik të fraksioneve yndyrore ku vihet re që ky raport është më i shprehur midis primipareve që vuajnë nga HISH.

Tabela 16. Përqendrimi i lipoproteinave tek gratë primipare me dhe pa hipertension të induktuar të shtatzënisë

Parametri	Gra shtatzëna me HISH Nr = 9	Gra shtatzëna pa HISH Nr=21	Gra jo-shtatzëna pa HISH Nr=12
Kolesterol total (mg/dl)	207.82±8.43	198.26±10.26*	206.28±16.47
HDL-kolesteroli (mg/dl)	43.87±1.79	42.78±2.06	53.20±2.36
LDL-kolesteroli (mg/dl)	117.83±7.99	103.68±10.53	101.55±14.37
VLDL-kolesteroli (mg/dl)	65.12±3.51	48.08±4.28	44.7±3.57
Trigliceridet (mg/dl)	236.74±10.67	240.96±21.43	223.4±17.87
TC: HDL-C (raport)	5.38±0.19	4.63±0.25	3.95±0.36
LDL-C: HDL-C (raport)	2.85±0.24	2.47±0.25	2.07±0.29
TG: HDL-C (raport)	5.83±0.50	5.79±0.59	4.41±0.43
HDL-C: VLDL-C (raport)	0.99±0.03	0.94±0.06	1.30±0.09
APO-A1 (mg/dl)	151.82±9.35	169.25±14.05	189.0±11.31
APO-B100 (mg/dl)	114.69±8.17	119.23±6.29	126.18±13.25
LDL: APO-B100	1.08±0.12	0.90±0.10	0.95±0.14
HDL: APO-A1	0.29±0.01	0.25±0.01	0.28±0.03

Edhe tabela e mëposhtme (tabela 17) evidenton faktin që përqendrimi lipoproteinik është më i lartë midis grave primipare që vuajnë nga hipertensioni i induktuar i shtatzënisë krahasuar me gratë primipare që nuk vuajnë nga HISH.

Tabela 17. Përqendrimi i lipoproteinave tek gratë primipare me dhe pa hipertension të induktuar të shtatzënisë

Parametri (mg/dl)	Me HISH Nr = 26	Pa HISH Nr=96	Ndryshimi (%)	Vlera P
Kolesterol total (mg/dl)	209.86±4.82*	206.28±16.47	1.7	0.131
HDL-kolesteroli (mg/dl)	41.91 ±0.90	53.20±2.36	26.9	0.001
